



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 601 Akti

Nr. 356 Vendimi  
Tiranë, më 16.3.2021

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

|                          |                  |
|--------------------------|------------------|
| <b>Brunilda Bekteshi</b> | <b>Kryesuese</b> |
| <b>Pamela Qirko</b>      | <b>Relatore</b>  |
| <b>Lulzim Hamitaj</b>    | <b>Anëtar</b>    |

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Gledis Hajdini, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar znj. Elka Ermenkova, në Tiranë, në datën 3 mars 2021, ora 9:45, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Marsela Pepi, gjyqtare**, aktualisht e komanduar si inspektore pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Pepi, me funksion gjyqtare, aktualisht e komanduar si inspektore pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është subjekt që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 3, pika 7 të rregullores “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) më 16.7.2020 zhvilloi procedurat e shortit të posaçëm të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Brunilda Bekteshi dhe Lulzim Hamitaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere, znj. Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 24.7.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese, znj. Brunilda Bekteshi, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin, znj. Marsela Pepi.

5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për znj. Pepi nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë, në përputhje me kreun IV të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e në vijim “DSIK”); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

10. **ILDKPKI-ja**, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë, ka dërguar një raport<sup>1</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti është konstatuar se:

➤ *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*

<sup>1</sup> Akti i kontrollit nr. \*\*\*\* prot., datë 8.1.2018.

- ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklaram të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

**11. DSIK-ja** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim ka dërguar raportin<sup>2</sup> e mbajtur për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**12. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ)** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsytuar për subjektin e rivlerësimit.

**13.** Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret, atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

**14.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 15.2.2021 vendosi: i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**15.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 15.2.2021, u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 17.2.2021 dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën 24.2.2021.

**16.** Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## II. SEANCA DËGJIMORE

**17.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë me *e-mail* në datën 25.2.2021.

**18.** Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 3.3.2021, ora 9:45, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

**19.** Subjekti i rivlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në

<sup>2</sup> Raporti nr. \*\*\*\* prot, datë 30.10.2017.

<sup>3</sup> Raporti për analizimin e aftësisë profesionale me nr. \*\*\*\* prot., datë 14.10.2020.

përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

### III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

**20.** Znj. Marsela Pepi ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ.

**20.1.** Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

**21.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**21.1.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**21.2.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**21.3.** Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

Ndërsa, në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**21.4.** Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017<sup>4</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**21.5.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; ç) deklaratat periodike të

---

<sup>4</sup> “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; dh) raportin e kontrollit të figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; ë) denoncimet e publikut; dhe f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

**22.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

**22.1.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion, i cili pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit.

**22.2.** Në deklaratën “Vetting”, të dorëzuar në ILDKPKI më 24.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme:

**23. Pasuria e llojit “depozitë bankare”, në shumën 2,821,939 lekë<sup>5</sup>.** Subjekti ka deklaruar se zotëron 50% të kësaj pasurie në “ProCredit Bank”, e hapur në datën 17.12.2008, në emër të bashkëshortit, z. A. M., me vlerë fillestare 450,000 lekë, duke u shtuar vlera ndër vite së bashku me interesat.

**23.1. Si burim krijimi** të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: i) të ardhura nga prodhimet bujqësore; ii) kursime nga pagat e saj dhe bashkëshortit; si dhe iii) të ardhurat nga shitja e automjetit “Mercedes – Benz”, tipi “250 D”, me kontratën nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 25.5.2016.

### Deklarimi i kësaj pasurie në vite

**24.1.** Referuar deklaratës periodike vjetore (në vijim “DPV”) të vitit 2008, të dorëzuar në ILDKPKI, konstatohet se subjekti ka deklaruar pasurinë e llojit “depozitë bankare”, në shumën 450,000 lekë, në “ProCredit Bank”. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar *të ardhurat e krijuara nga prodhimet bujqësore të dy viteve, të shitura gjatë vitit të deklaramit të deklaruesit dhe bashkëshortit, në emër të bashkëshortit.*

**24.2.** Në DPV/2009 subjekti ka deklaruar si shtesë pasurie të ardhurat e përfituara nga interesat bankarë për vitin 2009 nga depozita në “Procredit Bank”, në shumën 21,889 lekë;

**24.3.** Në DPV/2010 subjekti ka deklaruar: i) shumën 100,000 lekë si shtesë në depozitën bankare ekzistuese në “ProCredit Bank” me burim krijimi të ardhurat nga prodhimet bujqësore të dy viteve; dhe ii) shumën 22,620 lekë shtesë nga interesat bankarë për vitin 2010 të depozitës në të njëjtën bankë.

---

<sup>5</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së): i. dokumentin vërtetim depozite nga “ProCredit Bank”; ii. kontratë për hapje llogarie pranë “ProCredit Bank”; iii. kontratë për hapje depozite me afat; iv. autorizim për kryerje veprimesh bankare pranë “ProCredit Bank”.

**24.4.** Në DPV/2011 subjekti ka deklaruar: i) shumën 200,000 lekë si shtesë në depozitën bankare ekzistuese në “ProCredit Bank” me burim krijimi kursimet; si edhe ii) shumën 36,000 lekë shtesë nga interesat bankarë për vitin 2011 të depozitës në të njëjtën bankë.

**24.5.** Në DPV/2012 subjekti ka deklaruar: i) shumën 400,000 lekë si shtesë në depozitën bankare ekzistuese në emër të bashkëshortit në “ProCredit Bank” me burim krijimi kursimet; si edhe ii) shumën 22, 397 lekë shtesë nga interesat bankarë për vitin 2012 të depozitës në të njëjtën bankë.

**24.6.** Në DPV/2013 subjekti ka deklaruar: i) shumën 300,000 lekë si shtesë në depozitën bankare ekzistuese në emër të bashkëshortit në “ProCredit Bank” me burim krijimi kursime nga pagat; si edhe ii) interesat bankarë bruto të përfituara për vitin 2013 nga kjo depozitë në shumën 78,406 lekë (minus tatim në shumën 7,840 lekë).

**24.7.** Në DPV/2014 subjekti ka deklaruar: i) shumën 505,000 lekë si shtesë në depozitën bankare ekzistuese në emër të bashkëshortit në “ProCredit Bank” me burim krijimi kursime nga pagat; si edhe ii) interesat bankarë bruto të përfituara për vitin 2014 nga kjo depozitë në shumën 33,984 lekë (minus tatim në shumën 3,398 lekë).

**24.8.** Në DPV/2015 subjekti ka deklaruar: i) shumën 400,000 lekë si shtesë në depozitën bankare ekzistuese në emër të bashkëshortit në “ProCredit Bank” me burim krijimi kursime nga pagat; si edhe ii) interesat bankarë bruto të përfituara për vitin 2015 nga kjo depozitë në shumën 43,000 lekë (minus tatimin në shumën 4,300 lekë).

**24.9.** Në DPV/2016 subjekti ka deklaruar: i) shumën 200,000 lekë si shtesë në depozitën bankare ekzistuese në emër të bashkëshortit në “ProCredit Bank” me burim krijimi kursime nga pagat; si edhe ii) interesat bankarë bruto të përfituara për vitin 2016 nga kjo depozitë në shumën 43,946 lekë (minus tatimin në shumën 6,592 lekë).

### **Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri dhe burimi i krijimit**

**25.** “Procredit Bank”<sup>6</sup> konfirmon se në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit është hapur një llogari në monedhën lekë, në datën 17.12.2008 dhe mbyllur në datën 29.6.2017.

**25.1.** Nga lëvizjet e kësaj llogarie konstatohet se bashkëshorti i subjektit ka kryer depozitim në parë *cash* në datën 17.12.2008, në shumën 450,000 lekë, të cilat janë investuar në depozitë me afat.

**25.2.** Vlera e depozitës në datën 31.12.2016 është rezultat i shumave të shtuara nga viti në vit nga depozitimet e kryera *cash*, nga interesat e përfituara për periudhën 2008 - 2016 dhe për rrjedhojë, gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 ka qenë në vlerën 2,821,939 lekë, paraqitur në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr.1.**

| Viti | Data e depozitimit           | Shtesa <i>cash</i> gjatë vitit<br>lekë | Gjendja fund viti lekë |
|------|------------------------------|--|------------------------|
| 2008 | 17.12.2008                   | 450 000                                | 450 000                |
| 2009 |                              |  | 471 889                |
| 2010 | 31.12.2010                   | 100 000                                | 594 125                |
| 2011 | 28.12.2011                   | 200 000                                | 828 336                |
| 2012 | 20.07.2012 dhe<br>11.12.2012 | 150,000 + 250,000                      | 1 249 533              |
| 2013 | 17.06.2013                   | 300 000                                | 1 582 881              |
| 2014 | 17.12.2014                   | 505 000                                | 2 151 941              |

<sup>6</sup> Shkresa nr. prot OP-\*\*\*\*\*, datë 07.08.2020.

|      |            |         |           |
|------|------------|---------|-----------|
| 2015 | 28.12.2015 | 400 000 | 2 586 686 |
| 2016 | 29.12.2016 | 200 000 | 2 821 939 |

**25.3.** Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie ndër vite, në deklaratat periodike vjetore të depozituara në ILDKPKI, si edhe gjendjen e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”.

### **Të ardhurat e deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie**

**26.** Të ardhurat e deklaruara nga pjesa takuese e shitjes së produkteve bujqësore nga familjet bujqësore të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, bashkëshortit të saj.

Konstatohet se në deklaratën “Vetting”, në rubrikën e të ardhurave, është deklaruar shuma 1,515,000 lekë si të ardhura ndër vite nga toka bujqësore, të përfituar me ligjin nr. 7501 “Për tokën” nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, z. A. M..

**26.1.** Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, si edhe vetëdeklarimet e bëra në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur ndër vite kanë deklaruar të ardhura të përfituara nga shitja e produkteve bujqësore, në total në shumën 1,515,000 lekë, të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

#### **Tabela nr. 2.**

Të ardhurat e deklaruara si pjesë takuese nga shitja e produkteve bujqësore

| Viti i deklaramit                 | 2008              | 2010              | 2011    | 2012    | 2013    | 2014    | 2015    | Total     |
|-----------------------------------|-------------------|-------------------|---------|---------|---------|---------|---------|-----------|
| Periudha e krijimit të produkteve | 2007-2008         | 2009-2010         | 2011    | 2012    | 2013    | 2014    | 2015    |           |
| Nga familja e SR                  | (127,540+117,600) | (120,000+174,000) |         | 90,000  | 70,000  | 80,000  | 75,000  |           |
| Nga familja e bashkëshortit       | (112,460+102,400) | (27,000+59,000)   |         | 80,000  | 40,000  | 50,000  | 50,000  |           |
| Shuma në lekë                     | 450,000           | 380,000           | 150,000 | 170,000 | 110,000 | 130,000 | 125,000 | 1,515,000 |

**26.2.** Sikurse u pasqyrua më sipër, në deklaratën “Vetting” janë referuar si burim krijimi për depozitën objekt vlerësimi edhe të ardhurat e përfituara nga shitja e produkteve bujqësore, por subjekti nuk ka përcaktuar vlerën përkatëse të tyre.

Konstatohet se në DPV/2008 (viti kur është hapur kjo depozitë) subjekti ka deklaruar si burim krijimi të shumës 450,000 lekë (shuma fillestare e hapjes së depozitës) të ardhurat e krijuara nga prodhimet bujqësore të dy viteve, të shitura gjatë vitit të deklaramit, gjithashtu në DPV/2010 si burim krijimi të shtesës 100,000 lekë në këtë depozitë ka deklaruar të ardhurat nga prodhimet bujqësore të dy viteve. Ndërsa, në deklaratat e tjera periodike vjetore vijuese, në të cilat subjekti ka deklaruar shtesë të kësaj depozite, si burim krijimi ka deklaruar kursimet, kursimet nga pagat dhe nga shitja e një automjeti. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI rezulton se nuk është deklaruar burimi konkret i likuiditeteve në formën e kursimeve *cash*.

**26.3.** Në DPV/2011 subjekti ka deklaruar shtesë depozite në “Procredit Bank”, në shumën 200,000 lekë, me burim krijimi kursimet, por rezulton se nuk ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash* në vitet e mëparshme. Në këtë kuptim, rezulton se subjekti ka referuar si burim krijimi të shtesës së kësaj depozite kursimet e krijuara nga të ardhurat e përfituara gjatë vitit për të cilat është kryer edhe analiza financiare për verifikimin e mundësisë së krijimit të kësaj shume gjatë vitit 2011.

**26.4.** Po në këtë DPV, subjekti ka deklaruar si pasuri gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumën 400,000 lekë, të cilat rezultojnë i vetmi burim i deklaruar në vitin pasardhës si krijim i shtesës së depozitës në “ProCredit Bank”. Të ardhurat nga produktet bujqësore janë deklaruar në vlerën 150,000 lekë, ndërsa në raste të tjera si burim krijimi janë referuar kursimet nga pagat e vitit deklarues dhe në një rast shitja e automjetit. Për të dokumentuar pronësinë mbi tokën bujqësore, të ardhurat e krijuara nga aktiviteti bujqësor i familjes së saj dhe personit të lidhur, si edhe pagesën e detyrimeve përkatëse, subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës “Vetting” ka depozituar dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- i. AMTP-në<sup>7</sup> me nr. \*\*\*\* regjistri, për sipërfaqen e tokës bujqësore (tokë arë) prej 16,000 m<sup>2</sup>, në fshatin D\*\*\*\*, Korçë, lëshuar në favor të z. H. P., si kryefamiljar i familjes bujqësore;
- ii. AMTP-në<sup>8</sup> me nr. \*\*\* regjistri, për sipërfaqen e tokës bujqësore prej 8,408 m<sup>2</sup>, nga të cilat sipërfaqja prej 7,378 m<sup>2</sup> llojit “arë” dhe sipërfaqja prej 630 m<sup>2</sup> e llojit “pemëtore”, ndodhur në fshatin V\*\*\*\*, lëshuar në favor të z. R. M. (babai i bashkëshortit), si kryefamiljar i familjes bujqësore;
- iii. 4 (katër) certifikata për vërtetim pronësie<sup>9</sup>, lëshuar në datën 12.12.2000, për pasuri të llojit “tokë arë”, të ndodhura në V\*\*\*\*, Korçë, të regjistruara në emër të z. R. M.;
- iv. vërtetim nga Njësia Administrative L\*\*\*, Bashkia Maliq<sup>10</sup>, të datës 13.10.2016, sipas të cilit konfirmohet se subjekti i rivlerësimit, ish-banore e fshatit D\*\*\*\*, ka paguar taksat dhe tarifatat vendore në këtë njësi deri në vitin 2016;
- v. vërtetim nga Njësia Administrative L\*\*\*, Bashkia Maliq<sup>11</sup>, të datës 18.10.2016, sipas të cilit konfirmohet se subjekti i rivlerësimit, bazuar në regjistrin nr. \*\* të ndarjes së tokës sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, ka përfituar tokë bujqësore të llojit “arë”, me sipërfaqe 4,000 m<sup>2</sup>, kategoria e 3-të, ushtron aktivitet bujqësor dhe blegtoral dhe se ka shlyer detyrimet fiskale për vitin 2016;
- vi. vërtetim nga Njësia Administrative L\*\*\*, Bashkia Maliq<sup>12</sup>, të datës 17.10.2016, sipas të cilit konfirmohet se z. A. M.(bashkëshorti i subjektit), ish-banor i fshatit V\*\*\*\*, ka paguar taksat dhe tarifatat vendore në këtë njësi deri në vitin 2016;
- vii. vërtetim nga Njësia Administrative L\*\*\*, Bashkia Maliq<sup>13</sup>, të datës 17.10.2016, sipas të cilit konfirmohet se A. M., ish-banor i fshatit V\*\*\*\*, bazuar në regjistrin nr. \*\* të ndarjes së tokës sipas ligjit “Për tokën”, ka përfituar tokë bujqësore të llojit “arë”, me sipërfaqe 2,340 m<sup>2</sup>, ushtron aktivitet bujqësor dhe blegtoral dhe se ka shlyer detyrimet fiskale për vitin 2016;

**26.5.** Në përgjigje të pyetësorit nr. 1<sup>14</sup>, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *deri në kohën e dorëzimit të deklaratës “Vetting” ka përfituar ndër vite të ardhura në shumën 1,515,000 lekë nga shitja e prodhimeve bujqësore të realizuara në tokën e përfituar në bazë të ligjit, si pjesëtarë të familjes bujqësore respektive, vetë subjekti Marsela Pepi në normë për frymë 4,000 m<sup>2</sup> dhe bashkëshorti z. A. M. në normë për frymë 2,340 m<sup>2</sup>. Të ardhurat e siguruara janë deklaruar rregullisht në deklaratat periodike vjetore, si dhe në deklaratën “Vetting”. Për këto të ardhura, referuar legjislacionit në fuqi, ligji nr. 9632, datë 30.10.2016, ndryshuar në vitin 2015, janë paguar rregullisht prej tyre taksat e tokës bujqësore.*

**26.6.** Subjekti, në mbështetje të deklarimeve të saj dhe bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 1, ka depozituar dokumentacionin si vijon:

<sup>7</sup> Aneksi \*\*\* në dosjen e ILDKPKI -së.

<sup>8</sup> Aneksi \*\*\* në dosjen e ILDKPKI -së.

<sup>9</sup> Aneksi \*\*\* në dosjen e ILDKPKI -së.

<sup>10</sup> Vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 13.10.2016, ndodhur në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>11</sup> Vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2016, ndodhur në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>12</sup> Vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2016, ndodhur në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>13</sup> Vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2016, ndodhur në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI.

<sup>14</sup> Pyetja nr. 6 e pyetësorit nr. 1, pika 6.6 e përgjigjeve të dërguara nga subjekti.



- i. vërtetim nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkia Maliq<sup>15</sup>, të datës 29.7.2020, sipas të cilit konfirmohet se subjekti i rivlerësimit, ish-banore e fshatit D\*\*\*, Njësia Administrative L\*\*\*, ka përfituar tokë prej 4,000 m<sup>2</sup>, kategoria e 3-të, sipas ligjit “Për tokën”, është përdoruese e tokës bujqësore që prej vitit 1992 dhe se ka shlyer detyrimet fiskale për vitin 2020;
- ii. vërtetim nga Njësia Administrative L\*\*\*, Bashkia Maliq<sup>16</sup>, të datës 27.7.2020, sipas të cilit konfirmohet se subjekti i rivlerësimit i ish-banore në fshatin D\*\*\*, Njësia Administrative L\*\*\*, ka shlyer detyrimet deri në vitin 2020, sipas legjislacionit në fuqi.
- iii. vërtetim nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkia Maliq<sup>17</sup>, të datës 29.7.2020, sipas të cilit konfirmohet se z. A. M. (bashkëshorti i subjektit) ish-banor i fshatit V\*\*\*, Njësia Administrative L\*\*\*, Bashkia Maliq, ka përfituar tokë prej 2,340 m<sup>2</sup>, kategoria e 4-t, sipas ligjit “Për tokën”, është përdorues i tokës bujqësore që prej vitit 1992 dhe se ka shlyer detyrimet fiskale për vitin 2020;
- iv. vërtetim nga Njësia Administrative L\*\*\*, Bashkia Maliq<sup>18</sup>, të datës 27.7.2020, sipas të cilit konfirmohet se z. A. M., ish-banor në fshatin V\*\*\*, ka shlyer detyrimet deri në vitin 2020, sipas legjislacionit në fuqi;
  - v. certifikatë e përbërjes familjare, datë 1.8.1991, për familjen Pepi;
  - vi. certifikatë e përbërjes familjare, datë 1.10.1992, për familjen Pepi;
  - vii. certifikatë e përbërjes familjere, datë 1.8.1991, për familjen M.;
  - viii. certifikatë e përbërjes familjare, datë 1.10.1992, për familjen M.;
- ix. vërtetim nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkia Maliq<sup>19</sup>, të datës 3.8.2020, sipas të cilit konfirmohet se znj. B. P. (nëna e subjektit) si banore e fshatit D\*\*\*, Njësia Administrative L\*\*\*, Bashkia Maliq, ka përfituar tokë prej 4,000 m<sup>2</sup>, kategoria e 3-të, sipas ligjit “Për tokën” dhe se ka shlyer detyrimet fiskale për vitin 2020;
- x. vërtetim nga Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Bashkia Maliq<sup>20</sup>, të datës 3.8.2020, sipas të cilit konfirmohet se z. H. P. (babai i subjektit) si banor i fshatit D\*\*\*, Njësia Administrative L\*\*\*, ka përfituar tokë 4,000 m<sup>2</sup>, kategoria 3-të, sipas ligjit “Për tokën”, dhe se ka shlyer detyrimet fiskale për vitin 2020;
- xi. vërtetim nga Njësia Administrative L\*\*\*, Bashkia Maliq<sup>21</sup>, të datës 3.8.2020, sipas të cilit konfirmohet se z. H. P., si banor në fshatin D\*\*\*, ka shlyer detyrimet deri në vitin 2020, sipas legjislacionit në fuqi.

**26.7.** E pyetur nga Komisioni (pyetësi nr. 2) lidhur me të ardhurat e përfitura nga shitja e prodhimeve bujqësore nga vetë subjekti apo familjarët e saj (një pjesë e të cilave janë deklaruar si burim krijimi i depozitës objekt vlerësimi), **për vlerën e përfituar, kohën dhe mënyrën e përfitimit të këtyre të ardhurave për periudhën 2008 – 2016**, si edhe shlyerjen e detyrimeve tatimore përkatëse, subjekti i rivlerësimi deklaroi se<sup>22</sup> *përdorimi dhe shfrytëzimi i pasurisë së përbashkët bujqësore, mbjellja e kulturave të ndryshme është organizuar dhe mbikëqyrur nga secili prej përfaqësuesve të familjes bujqësore për totalin e pasurisë së familjes, me ndihmën edhe të secilit prej anëtarëve të familjes gjatë periudhave të fushatës. Shitja e produkteve të përfituara nga kultivimi i tokës bujqësore është kryer sërish nga secili kryefamiljar si përfaqësues ligjor i familjes së vet bujqësore. Këto shitje janë realizuar ndër vite nga viti 1992 e në vijim tek bashkëfshatarët apo blerës të tjerë në treg informal sipas çmimeve që ky treg ofronte, duke krijuar të ardhura për familjet respektive. Pas vitit 2005, me lidhjen e martesës së subjektit me*

<sup>15</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 29.7.2020.

<sup>16</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2020.

<sup>17</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 29.7.2020.

<sup>18</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2020.

<sup>19</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2020.

<sup>20</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2020.

<sup>21</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2020.

<sup>22</sup> Pyetja nr. 1 e pyetësorit nr. 2, përgjigjet e dërguara nga subjekti.

z. A. M., prindërit vendosën që të ardhurat e realizuara, në përputhje me kontributin dhe pjesën takuese në pasuri, t'ua jepnin cash me qëllim për të ndihmuar jetesën e përbashkët.

**26.8.** Krahas dokumentacionit të depozituar më parë (me dorëzimin e deklaratës “Vetting” dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 1), në mbështetje të deklarimeve të saj, të bëra në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka depozituar si prova shtesë dokumentacionin si vijon:

- i. deklaratë noteriale<sup>23</sup> e shtetasit R. M. , e datës 16.10.2020;
- ii. deklaratë noteriale<sup>24</sup> e shtetasit H. P., e datës 16.10.2020;
- iii. 2 (dy) kontrata shitblerjeje pasurie<sup>25</sup>, të datës 17.6.2013.

**26.9.** Lidhur me **pagesën e detyrimeve tatimore për të ardhurat** e pretenduara si të përfituara nga shitja e produkteve bujqësore, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se referuar nenit D, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 3 pika 19 e ligjit nr. 84/2016, mbi përkufizimin e të ardhurës së ligjshme, burimi i krijimit të të ardhurave, duhet të jetë i parashikuar në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat”. Pra, burimi i të ardhurave është i ligjshëm, nëse nga ligji specifik përcaktohet si një nga burimet e të ardhurave të krijuara. Neni 4, germa “dh” e ligjit të zbatueshëm nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ka parashikuar si një nga burimet e ligjshme të të ardhurave, pikërisht ato të realizuara **nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme, aksesoret dhe frytet e tyre**, si dhe të ardhurat nga të drejta të tjera, që rrjedhin nga pronësia mbi sendet e paluajtshme, në rast se këto sende ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Pra, në koncept të parashikimit kushtetues dhe atij ligjor, të ardhurën e ligjëron burimi i krijimit, që do të thotë të ardhurat nga bashkëpronësia në tokën bujqësore, duke marrë pjesën takuese nga shitja, që përfaqësuesi i familjes bujqësore në zbatim të parashikimit ligjor të nenit 224 të K.Civil u ka bërë fryteve të kësaj pasurie, është një nga burimet e ligjshme sipas ligjit specifik nr. 8438/1998 dhe parashikimit të nenit 3/19 të ligjit nr. 84/2016.

**27.** Në mbështetje të deklarimeve të saj, subjekti ka depozituar dokumentacion shtesë provues, si vijon:

- i. vërtetim nga Njësia Administrative L\*\*\*\*, Bashkia Maliq<sup>26</sup>, datë 16.10.2020, sipas të cilit konfirmohet se z. R. M. , si banor në fshatin V\*\*\*\*, ka paguar detyrimet deri në vitin 2020, sipas legjislacionit në fuqi;
- ii. vërtetim nga Njësia Administrative L\*\*\*, Bashkia Maliq<sup>27</sup>, datë 16.10.2020, sipas të cilit konfirmohet se z. H. P., si banor në fshatin D\*\*\*, ka paguar detyrimet deri në vitin 2020, sipas legjislacionit në fuqi.

**27.1.** Në vijim të shpjegimeve të dhëna në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se i) ajo dhe bashkëshorti nuk ushtronin dhe as ushtrojnë aktivitet ekonomik në lidhje me këtë pasuri, për rrjedhojë nuk kanë pasur detyrimin të paguajnë tatim sipas legjislacionit në fuqi; ii) në asnjë rast, as në DPV-të periodike dhe as në atë “Vetting”, kjo e ardhur nuk është deklaruar si pasuri, që rrjedh nga aktiviteti ekonomik mbi pasurinë, por si të ardhura nga prodhimet bujqësore për pjesën e tyre takuese nga bashkëshkëpronësia; iii) ligjshmëria lidhet me burimin e krijimit dhe jo me pagesën tatimore mbi këto ta ardhura; iv) ligji tatimor nuk parashikon detyrim për pagim tatimi dhe as ndalim për të përfituar pjesën nga bashkëpronësia në tokën bujqësore dhe të ardhurat e krijuara nga frytet e saj.

<sup>23</sup> Deklatë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.10.2020.

<sup>24</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, datë 16.10.2020.

<sup>25</sup> Kontratë shitblerjeje pasurie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., dhe nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol, të datës 17.6.2016, për shitjen e pasurive nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, përfituar më parë me ligjin nr. 7501.

<sup>26</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2020.

<sup>27</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2020.

**27.2.** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar një situacion të datës 12.8.2020, të përpiluar nga z.A.H.<sup>28</sup> me anë të të cilit analizohet sipas sipërfaqes takuese rendimenti, prodhimi, çmimi për të përlllogaritur të ardhurat bruto, si dhe shpenzimet që vijnë nga shërbimet kryesore, duke përcaktuar dhe vlerën e të ardhurave neto të realizuara për pjesën respektive të tokës të përfituar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, sipas ligjit nr. 7501 “Për tokën”.

**27.3.** Nga analizimi i dokumentit të mësipërm rezulton se ky akt është kryer mbi të dhëna hipotetike për prodhimin e kulturave bujqësore dhe rrjedhimisht edhe për shitjen e tyre. Vlerësimi është kryer bazuar mbi të dhëna verbale të marra nga personat e tjerë të lidhur, ndërkohë që prej tyre nuk rezulton të jenë mbajtur dëftesa për mënyrën e krijimit të këtyre të ardhurave për periudhën 2008-2015, si dhe nuk është referuar ndonjë dokumentacion mbështetës nga eksperti që ka kryer situacionin. Nga krahasimi i të ardhurave të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur në deklaratat periodike vjetore, si të ardhura të përfituara nga shitja e produkteve bujqësore për pjesën e tyre takuese me të ardhurat e përlllogaritura në situacionin e mësipërm, rezulton se vlerat totale vjetore të paraqitura nga eksperti dhe ato të deklaruara nga subjekti janë të njëjta për të gjitha vitet dhe me një marzh gabimi 0 (zero) lekë për të gjitha vitet.

**27.4.** Lidhur me kohën e përfitimit (periudhën) dhe vlerën respektive të këtyre të ardhurave, në referim të aktit (situacion) të datës 12.8.2020, deklaratave noteriale të bëra nga secili prej prindërve si dhe DPV-ve vjetore, subjekti ka deklaruar se:

- i. totali i të ardhurave për dy vitet (2007 – 2008) që i janë dhënë në vitin 2008 kanë qenë në vlerën 450,000 lekë (për vitin 2007 totali i të ardhurave 230,000 lekë, nga të cilat pjesa takuese e saj 127,540 lekë dhe pjesa takuese e bashkëshortit 112,460 lekë; ndërsa për vitin 2008 totali i të ardhurave 220,000 lekë, nga të cilat pjesa takuese e saj 117,600 lekë dhe pjesa takuese e bashkëshortit 102,400 lekë);
- ii. totali i të ardhurave për dy vitet (2009 – 2010) që i janë dhënë në vitin 2010 kanë qenë në vlerën 380,000 lekë (për vitin 2009 totali i të ardhurave 147,000 lekë, nga të cilat pjesa takuese e saj 120,000 lekë dhe pjesa takuese e bashkëshortit 27,000 lekë; ndërsa për vitin 2010 totali i të ardhurave 233,000 lekë, nga të cilat pjesa takuese e saj 174,000 lekë dhe pjesa takuese e bashkëshortit 59,000 lekë);
- iii. totali i të ardhurave që i janë dhënë në vitin 2011 nga shitja e produkteve bujqësore ka qenë në vlerën 150,000 lekë, nga të cilat pjesa takuese e saj 92,400 lekë dhe pjesa takuese e bashkëshortit 57,600 lekë;
- iv. totali i të ardhurave që i janë dhënë në vitin 2012 nga shitja e produkteve bujqësore, ka qenë në vlerën 170,000 lekë, nga të cilat pjesa takuese e saj 90,000 lekë dhe pjesa takuese e bashkëshortit 80,000 lekë;
- v. totali i të ardhurave që i janë dhënë në vitin 2013 nga shitja e produkteve bujqësore ka qenë në vlerën 110,000 lekë, nga të cilat pjesa takuese e saj 70,000 lekë dhe pjesa takuese e bashkëshortit 40,000 lekë;
- vi. totali i të ardhurave që i janë dhënë në vitin 2014 nga shitja e produkteve bujqësore ka qenë në vlerën 130,000 lekë, nga të cilat pjesa takuese e saj 80,000 lekë dhe pjesa takuese e bashkëshortit 50,000 lekë;
- vii. totali i të ardhurave që i janë dhënë në vitin 2015 nga shitja e produkteve bujqësore ka qenë në vlerën 125,000 lekë, nga të cilat pjesa takuese e saj 75,000 lekë dhe pjesa takuese e bashkëshortit 50,000 lekë.

**27.5.** Subjekti ka sqaruar se *të ardhurat që i janë dhënë në vitet 2005 – 2006 i ka shpenzuar, ndërsa të ardhurat në vijim të detajuara si më sipër nga viti 2007 – 2015 në vlerën totale 1,515,000 lekë nuk i ka përdorur, por i kanë kursyer duke i vendosur në depozitë. Nga kjo shumë, sasia prej 550,000 lekësh është depozituar në llogarinë e hapur në “Procredit Bank” në emër të*

<sup>28</sup> Zoti A. H. rezulton të jetë specialist i Agjencisë Rajonale të Shërbimit Veterinar e Mbrojtjes së Bimëve, Korçë, i diplomuar “Agronom i lartë” A- \*\*\*, në Institutin e Lartë Bujqësor Korçë, në datën 22.1.1989.

personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit) nëpërmjet depozitimit të dy shumave 450,000 lekë dhe 100,000 lekë. Pjesa tjetër e mbetur, në vlerën 965,000 lekë, është depozituar periodikisht në llogarinë e hapur për fëmijën e mitur K. M. pranë BKT-së, si një nga burimet e depozitimit të llogarive, përkatësisht në vitet 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015. Pra, këto të ardhura u janë shtuar të ardhurave të tjera që kanë patur ndër vite, të deklaruara rregullisht dhe pavarësisht se nuk është përdorur termi kursim për këtë shumë, logjika e përdorur në plotësimin e secilës deklarate është pikërisht që kjo shumë është konsideruar si kursim, duke u deklaruar si një prej burimeve të krijimit të depozitës së fëmijës K. , të cilat depozitoheshin në vitin pasardhës. Kjo shumë në asnjë rast nuk është përdorur për asnjë lloj shpenzimi tjetër, por destinacioni i saj ka qenë depozitimi në llogari, në funksion të arsimimit të fëmijës K. .

**27.6.** E pyetur nga Komisioni lidhur me marrëdhënien e punësimit të prindërve të saj dhe të bashkëshortit, subjekti ka deklaruar se ata në periudha të caktuara rezultojnë të kenë qenë të vetëpunësuar në bujqësi dhe se kanë paguar rregullisht kontributet përkatëse.

Për të provuar aktivitetin bujqësor të familjarëve të saj dhe personit të lidhur, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, ka depozituar edhe dokumentet si vijon:

- i. vërtetim i DRSSH-së Korçë “Për të vetëpunësuarit në bujqësi”, i datës 30.3.2004, nëpërmjet të cilit vërtetohet se z. R. M. , banor i Komunës L\*\*\*, fshati V\*\*\*, ka tokë në pronësi, përdorim dhe figuron i regjistruar në regjistrin e bujkut privat me nr. \*\*\*. Në këtë vërtetim janë pasqyruar edhe vitet për të cilat janë derdhur kontributet dhe mandatpagesat, përkatësisht për vitet 1993 – 2004.
- ii. vërtetim i DRSSH-së Korçë<sup>29</sup> “Për të vetëpunësuarit në bujqësi”, datë 16.7.2014, sipas të cilit vërtetohet se z. R. M. , banor i Komunës L\*\*\*, i fshatit V\*\*\*, ka tokë në pronësi, përdorim që nga viti 1991 dhe figuron i siguar si vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 2005 në regjistrin themeltar të të vetëpunësuarve në bujqësi me nr. \*\*\*. Në këtë vërtetim janë pasqyruar edhe vitet për të cilat janë derdhur kontributet, përkatësisht për periudhën 1.1.2005 – 31.12.2006.

Pra, nga verifikimi i këtyre dy vërtetimeve, rezultojnë se z. R. M. ka qenë i regjistruar dhe ka paguar kontributet përkatëse si i vetëpunësuar në bujqësi për periudhën 1993 – 2006.

iii. vërtetimi i DRSSH-së Korçë “Për të vetëpunësuarit në bujqësi”, datë 7.11.2013, sipas të cilit vërtetohet se z. H. P., banor i komunës L\*\*\*, i fshatit D\*\*\*, ka tokë në pronësi, përdorim që nga viti 1991, dhe figuron i regjistruar si i vetëpunësuar në bujqësi që nga viti 1993 në regjistrin themeltar të të vetëpunësuarve në bujqësi me nr. \*\*\*.

Nga ky vërtetim rezultojnë se z. H. P. në datën 29.9.1999 ka paguar kontributet përkatëse si i vetëpunësuar në bujqësi për periudhën 1.10.1993 – 31.12.1999, ndërsa në datën 29.10.2013 ka paguar kontributet përkatëse si i vetëpunësuar në bujqësi për periudhën 1.1.2000 – 31.1.2000 dhe 1.1.2013 – 30.11.2013.

**27.7.** DRSSH-ja Korçë<sup>30</sup> informon se z. H. P. për periudhën 1.10.1993 – 31.1.2000 dhe 1.1.2013 – 30.1.2013 ka paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore si i vetëpunësuar në bujqësi, ndërsa z. R. M. për periudhën 1.10.1993 – 30.9.2004 dhe 1.1.2005 – 31.12.2006 ka paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore si i vetëpunësuar në bujqësi.

**27.8.** ASHK-ja, Drejtoria Vendore Korçë<sup>31</sup> konfirmon se në emër të shtetasit R. M. rezultojnë të regjistruara dhe të tjetërsuara pasuritë si më poshtë: i) pasuria nr. \*\*\*, volum \*\*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, Vloçisht, pasuri e llojit “arë” me sipërfaqe 2,220 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\* dhe me sipërfaqe 2,147 m<sup>2</sup> sipas LN; ii) pasuria nr. \*\*\*, volum \*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*,

<sup>29</sup> Vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2014.

<sup>30</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2020.

<sup>31</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2020.

Vloçisht, pasuri e llojit “arë”, me sipërfaqe 953 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\* dhe me sipërfaqe 953 m<sup>2</sup> sipas LN; iii) pasuria nr. \*\*\*, volum \*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, Vloçisht, pasuri e llojit “arë”, me sipërfaqe 900 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së \*\*\*, dhe me sipërfaqe 900 m<sup>2</sup>, sipas LN; iv) pasuria nr. \*\*\*, volum \*\*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, Vloçisht, pasuri e llojit “arë”, me sipërfaqe 630 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së \*\*\* dhe me sipërfaqe 624 m<sup>2</sup> sipas LN (rezulton e shitur; ref. \*\*\*); v) pasuria \*\*\*, volum \*\*, faqe \*\*, zona kadastrale \*\*\*, Vloçisht, pasuri e llojit “arë”, me sipërfaqe 2,147 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së \*\*\*\* dhe me sipërfaqe 2,200 m<sup>2</sup>, sipas LN; vi) pasuria nr. \*\*\*, volum \*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, Vloçisht, pasuri e llojit “arë + truall”, me sipërfaqe 528 m<sup>2</sup>, nga të cilat 400 m<sup>2</sup> truall sipas AMTP-së nr. \*\*\*, dhe me sipërfaqe 648 m<sup>2</sup>, nga të cilat 400 m<sup>2</sup> truall dhe 100 m<sup>2</sup> ndërtesë, sipas LN; vii) pasuria nr. \*\*\*, volum \*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, Vloçisht, pasuri e llojit “arë”, me sipërfaqe 1,050 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\*, me sipërfaqe 1,080 m<sup>2</sup>, sipas LN dhe me sipërfaqe 735 m<sup>2</sup> rezulton pasuri e shitur (ref. \*\*\*).

**27.9.** Ndërsa, në emër të shtetasit H. P. rezultojnë të regjistruara pasuritë si më poshtë: i) pasuria nr. \*\*\*, volum \*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, Dloçisht, pasuri e llojit “arë”, me sipërfaqe 2,140 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së \*\*\* dhe me sipërfaqe 2,140 m<sup>2</sup>, sipas LN; ii) pasuria nr. \*\*\*, volum \*\*, faqe \*\*, zona kadastrale \*\*\*, Dloçisht, pasuri e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 10,360 m<sup>2</sup>, sipas AMTP-së nr. \*\*\* dhe me sipërfaqe 10,360 m<sup>2</sup>, sipas LN; iii) pasuria nr. \*\*\*, volum \*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, Dloçisht, pasuri e llojit “tokë arë”, me sipërfaqe 3,500 m<sup>2</sup> sipas AMTP-së nr. \*\*\* dhe me sipërfaqe 3,500 m<sup>2</sup>, sipas LN.

**28.** Në vijim të kryerjes së verifikimeve lidhur me aktivitetin bujqësor, pasi Komisioni kërkoi<sup>32</sup> informacion të detajuar lidhur me pagesat e kryera për tokën bujqësore në përdorim/pronësi nga familjet bujqësore të sipërcituara, Bashkia Maliq<sup>33</sup> informoi se nga të dhënat që disponon Zyra e Tatimit Taksave në Njësinë Administrative Lloçisht, pagesat për tokën bujqësore fillojnë nga viti 2003, ndërsa për periudhën 1992 – 2002 nuk ka informacion pranë kësaj njësie. Bashkëlidhur shkresës “kthim përgjigjeje” janë dërguar kopje të regjistrimit ku pasqyrohen evidencat mbi shlyerjen e detyrimeve nga shtetasit H. P. dhe R. M. për pagesat e taksës mbi tokën bujqësore, taksë vergjije dhe taksë pastrimi.

**28.1.** Nga verifikimi i këtyre evidencave rezulton se z. H. P. ka kryer pagesat për tokën bujqësore dhe taksave të tjera në mënyrë kronologjike gjatë viteve përkatës, për periudhën 2003 – 2020. Ndërsa, për z. R. M. konstatohet se në datën 17.10.2016 ka kryer pagesat për tokën bujqësore për vitet 2003 – 2016.

**28.2.** Gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *prindërit e bashkëshortit, z. R. M. dhe znj. L. M., kanë qenë me marrëdhënie pune në Tiranë, të punësuar për periudhat dhe në subjektet si më poshtë:*

a) z. R. M. : i) prej vitit 1999 - 2003 si menaxher shitjesh në shoqërinë “\*\*\*\*\*” sh.p.k, Tiranë; ii) prej vitit 2001 - 2007 si administrator pranë subjektit “\*\*\*\*\*”, Tiranë; iii) në periudhën 1999 - 2007 pranë grupit të punës si sipërmarrës.

b) znj. L. M. : i) punësuar në Drejtorinë Arsimore Rajonale Tiranë gjatë periudhës tetor 1999 deri në daljen në pension në vitin 2016; dhe ii) ka përfutur pension invaliditeti nga viti 2008-2016.

**28.3.** Pra, rezulton se prej vitit 1999 prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë jetuar e punuar në Tiranë. Ndërkohë, sikurse u pasqyrua më sipër, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore rezulton se për periudhën 2005 e në vijim subjekti/personi i lidhur (bashkëshorti) ka deklaruar të ardhura të përfuturara nga toka bujqësore, në pronësi të familjarëve të bashkëshortit. Ndërsa, referuar deklaratës noteriale të datës 16.10.2020, z. R. M. ka deklaruar se që nga viti 2005 i ka

<sup>32</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2020 drejtuar Njësisë Administrative Lloçisht.

<sup>33</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2020.

dhënë bashkëshortit të subjektit pjesën e tij të ardhurave nga shitja e produkteve bujqësore, që lidhen me tokën në pronësi të familjes M. .

**28.4.** Pasi Komisioni i kërkoi subjektit deklaram lidhur me punimin, përdorimin, administrimin e tokës bujqësore si edhe në ç'mënyrë kanë përfiturar të ardhura familjarët e bashkëshortit nga kjo tokë për periudhën nga viti 2005 e në vijim, ndërkohë që në këtë periudhë kanë punuar e jetuar në Tiranë, subjekti i rivlerësimit deklaroi se<sup>34</sup>....*deklarimi i saj bazohet në deklaramet e bëra nga vetë shtetasi R.M. , pasi nuk ka dijeni të drejtpërdrejtë për mënyrën se si ka vepruar ai praktikisht në këtë periudhë, kjo edhe për faktin se për periudhën nëntor 2006 - korrik 2013 ka qenë për shkak të detyrës jashtë qytetit të Tiranës dhe merrte dijeni nga komunikimi telefonik për fakte të përgjithshme të natyrës: “ndodheshin në Korçë për kryerjen e punëve sezonale që lidheshin me produktet bujqësore”.*

**28.5.** Në vijim ka shpjeguar se vjehri i saj R.M. ka deklaruar më parë se përdorimi dhe menaxhimi i pasurisë së paluajtshme të përfiturar me ligjin “Për tokën” është kryer prej tij për llogari të të gjithë familjes së tij. *Produktet e krijuara nga shfrytëzimi i kësaj pasurie janë shitur po prej tij në treg informal tek banorë të zonës, blerës të ndryshëm sipas kulturave bujqësore të prodhuara ndër vite.*

**28.6. Shtetasi R. M.** i ripyetur nga subjekti për sa iu kërkua nga Komisioni, ka shpjeguar se nisur nga kategoria e tokës që familja e tyre ka përfiturar (tokë arë dhe pemëtore) *kulturat bujqësore të mbjella prej tij ndryshonin herë pas herë për të rritur prodhueshmërinë maksimale të tokës. Ai ka detajuar mënyrën e punimit/përdorimit dhe menaxhimit të tokës bujqësore nga qyteti i Tiranës ku jetojnë, në atë të fshatit V\*\*\*, Korçë ku kanë jetur dhe ku ndodhen tokat bujqësore të familjes së tyre. Disa shërbime të ndryshme të tokës janë kryer prej tij dhe bashkëshortes së tij gjatë kohës kur ajo nuk ishte në punë, ndër to edhe mbledhja e frutave në periudhën gusht-shtator. Shitja e tyre është kryer direkt në terren pasi blerësit i merrnin aty produktet me mjetet e tyre të transportit. Shërbime të tjera si plugim, diskim, mbjellje, që nuk kërkonin praninë e tyre fizike janë bërë me ndihmën e me anë të porosisë me telefon tek fshatarët e zonës që i ofronin këto shërbime me mjetet e tyre të cilët kishin dijeni të plotë të vendodhjes së këtyre tokave bujqësore. Pagesat për shitjen e patateve, fasuleve, etj., bëheshin cash në dorë sikundërse ndodh zakonisht për këto lloj produktesh, pasi nuk ishte aktivitet i mirëfilltë tregtar që të shoqërohej me dokumentim të shumave të marra nga shitja e tyre.*

*Nga viti 2008 e në vijim nuk ka qenë më i punësuar në Tiranë pasi edhe aktiviteti i tij si sipërmarrës me grupin e ndërtimit u ndërpre dhe nuk kishte asnjë lloj pengese për t’iu përkushtuar totalisht edhe me praninë fizike pjesës së punimit, përdorimit të tokës bujqësore dhe administrimit të shërbimeve dhe produkteve të prodhuara prej saj.*

**28.7.** Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti depozitoi si dokumentacion provues deklaratën noteriale<sup>35</sup> të shtetasit R. M. të datës 11.12.2020.

Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar dhe vetëdeklarimeve të bëra në ILDKPKI dhe gjatë procesit të hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të dokumentuar të ardhurat e përfituara dhe pagesën e detyrimeve përkatëse mbi këto të ardhura, deklaruar si pjesë takuese nga shitja e prodhimeve bujqësore, të cilat kanë shërbyer/janë deklaruar si burim krijimi i depozitës objekt vlerësimi.

### **Kursime nga pagat e subjektit dhe e bashkëshortit**

**28.8.** Lidhur me të ardhurat nga punësimi i subjektit dhe i bashkëshortit në periudhën e krijimit të depozitës dhe të shtesave të kryera në të për periudhën 2008-2016, Komisioni iu referua

<sup>34</sup> Pyetja nr. 2 e pyetësorit nr. 4, përgjigjet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit.

<sup>35</sup> Deklarata noteriale me nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol., datë 11.12.2020.

vërtetimeve të pagave nga institucionet përkatëse, si dhe lëvizjeve të llogarive për pagat e përfituara gjatë kësaj periudhe nga subjekti dhe bashkëshorti.

### **Të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit “Mercedes-Benz”, tipi “250 D” me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., data 25.5.2016<sup>36</sup>**

**28.9.** Në DPV/2016 subjekti ka deklaruar shtim në vlerë në depozitën bankare ekzistuese në “Procredit Bank” të hapur në emër të bashkëshortit A.M. , data e shtimit 29.12.2016, me burim krijimi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit të mësipërm në shumën 200,000 lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga DPSHTRR-ja<sup>37</sup> konfirmohet se personi i lidhur ka pasur në pronësi automjetin e mësipërm, blerë<sup>38</sup> në vitin 2007<sup>39</sup> në shumën 250,000, dhe gjithashtu konfirmohet shitja<sup>40</sup> e këtij mjete në datën 25.5.2016, në shumën 200,000 lekë.

Në kuptim të analizës financiare, të ardhurat nga shitja e këtij automjeti janë konsideruar si burim për krijimin e shtesës së depozitës bankare në “Procredit Bank”.

**29. Pasuria e llojit “depozitë bankare”, në shumën 13,581 euro<sup>41</sup>.** Subjekti ka deklaruar depozitë bankare pranë BKT-së, e hapur në emër të fëmijës së mitur K.M. më 31.12.2010, me vlerë fillestare 2,000 euro, duke u shtuar vlera ndër vite së bashku me interesat.

**29.1. Si burim krijimi** të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: i) të ardhura nga prodhimet bujqësore; ii) kursime nga pagat; si dhe iii) dhurata nga gjyshërit respektivë të fëmijës për ditëlindje e festa të ndryshme ndër vite.

### **Deklarimi i kësaj pasurie në vite**

**30.** Në DPV/2010 subjekti ka deklaruar depozitë bankare në BKT, në vlerën 2,000 euro, në emër të fëmijës së mitur K. M. , me burim krijimi vlerat e dhuruara të deklaruara në formularin e deklarimit datë 8.3.2009 (rezulton të jetë lapsus, data e saktë referuar formularit DPV/2009 është 8.3.2010) dhe ato të dhuruara gjatë vitit të deklarimit. Gjithashtu, në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale” subjekti ka deklaruar si dhurata me rastin e njëvjektorit të djalit K. : i) shumën 50,000 lekë nga babai i saj, z. H. P.; dhe ii) shumën 30,000 lekë nga babai i bashkëshortit, z. R. M. .

**30.1.** Në DPV/2009 konstatohet se në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale” subjekti ka deklaruar si dhurata me rastin e lindjes së fëmijës K.: i) shumën 100,000 lekë nga babai i saj z. H. P.; dhe ii) shumën 60,000 lekë nga babai i bashkëshortit, z. R. M. .

**30.2.** Por nuk rezulton që në DPV/2009 të ketë deklaruar shtesë pasurie në formë likuiditësh *cash*, me burim dhurimet e vlerave monetare nga familjarët, të konstatuara si më sipër dhe, si rrjedhim, rezulton se ato nuk mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e kësaj depozite.

Pas kalimit të barrës së provës, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimi ka pranuar se qëndron konstatimi i Komisionit se kjo shumë e dhuruar nuk është deklaruar si shtesë pasurie në formë likuiditetesh *cash*, duke pretenduar ndër të tjera se kjo pasaktësi ka ardhur si pasojë e kuptimit të mënyrës së plotësimit të deklaratës periodike vjetore prej saj, pasi ka menduar se ka qenë e mjaftueshme ta deklaronte vetëm si të ardhur apo dhurim, duke nënkuptuar edhe kursim, për sa kohë nuk është deklaruar si shumë e shpenzuar apo e investuar në llogarinë depozitë në atë vit. Në vijim, subjekti ka shpjeguar se shuma e dhuruar ka

<sup>36</sup> Me dorëzimin e deklaratës “Vetting” subjekti ka depozituar kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.5.2016 – aneksi \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>37</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2020.

<sup>38</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.11.2007.

<sup>39</sup> Në DPV/2007 subjekti/personi i lidhur ka deklaruar blerjen e këtij mjete.

<sup>40</sup> Kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.5.2016.

<sup>41</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës: aneksi \*\* në dosjen e ILDKPKI-së; vërtetim nga BKT-ja, me nr. \*\*\* prot., datë 12.1.2017; librezë 12-mujore për depozitën “Flex” në BKT, në emër të K. M. .

pasur si destinacion krijimin e depozitës në emër të fëmijës K. M. , duke u përrputhur me qëllimin e dhuruesve dhe se ky fakt është specifikuar në vitin pasardhës, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010.

**30.3.** Pas analizimit të provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se kjo pasaktësi nuk mund të vlerësohet si deklaram i pamjaftueshëm në kuptim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë subjekti ka deklaruar në vitin pasardhës destinacionin e këtyre dhurimeve, duke nënkuptuar indirekt se shumt e dhuruara kanë qenë si gjendje likuiditetesh *cash* në vitin paraardhës, pavarësisht mosdeklarimit në mënyrë eksplicite të tyre me këtë emërtim. Për më tepër, Komisioni vëren se në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se shumt e dhuruara ndër vite nga gjyshërit kanë shërbyer si burim krijimi i kësaj depozite.

Në këtë kuptim, Komisioni çmon se me rëndësi për këtë proces është verifikimi i ligjshmërisë së burimeve financiare të personave të tjerë të lidhur për mundësinë e kryerjes së këtyre dhurimeve.

**30.4.** Në DPV/2011 subjekti ka deklaruar shtim në vlerë shumën 2,000 euro, në depozitën bankare ekzistuese pranë BKT-së, në emër të fëmijës së mitur K. M. . Si burim krijimi të kësaj shume ka deklaruar: i) vlerat e dhuruara; ii) të ardhurat nga prodhimet bujqësore për vitin 2010; dhe iii) kursimet. Data e shtimit të depozitës: 28.12.2011.

Në DPV/2010 subjekti ka deklaruar të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore të dy viteve shumën 380,000 lekë.

**30.5.** Gjithashtu konstatohet se në DPV/2011 subjekti ka deklaruar shumën 150,000 lekë si të ardhura të përfituara nga shitja e prodhimeve bujqësore, si edhe dhurimet e bëra me rastin e dyvjetorit të djalit, përkatësisht shumën 50,000 lekë dhuruar nga babai i saj, z. H. P. dhe shumën 40,000 lekë dhuruar nga babai i bashkëshortit, z. R. M. .

**30.6.** Në DPV/2012 subjekti ka deklaruar shtim në vlerë shumën 2,000 euro, në depozitën bankare ekzistuese pranë BKT-së në emër të fëmijës së mitur K. M. . Si burim krijimi të kësaj shume ka deklaruar: i) vlerat e dhuruara; dhe ii) të ardhurat nga prodhimet bujqësore të deklaruara për vitin 2011. Në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale” subjekti ka deklaruar si dhurata me rastin e 3- vjetorit të djalit, K. : i) shumën 40,000 lekë nga babai i saj, z. H. P.; dhe ii) shumën 30,000 lekë nga babai bashkëshortit, z. R. M..

**30.7.** Në DPV/2013 subjekti ka deklaruar shtim në vlerë shumën 2,000 euro, në depozitën bankare ekzistuese pranë BKT-së në emër të fëmijës së mitur K. M. . Si burim krijimi të kësaj shume ka deklaruar: i) vlerat e dhuruara; dhe ii) të ardhurat nga prodhimet bujqësore të deklaruara për vitin 2012. Në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale” subjekti ka deklaruar si dhurata me rastin e 4- vjetorit të djalit, K. : i) shumën 35,000 lekë nga babai i saj, z. H. P.; dhe ii) shumën 35,000 lekë nga babai bashkëshortit, z. R. M..

**30.8.** Në DPV/2014 subjekti ka deklaruar shtim në vlerë shumën 2,000 euro, në depozitën bankare ekzistuese pranë BKT-së në emër të fëmijës së mitur K. M. . Si burim krijimi të kësaj shume ka deklaruar: i) vlerat e dhuruara; ii) të ardhurat nga prodhimet bujqësore të deklaruara për vitin 2013; dhe iii) kursime page. Në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale” subjekti ka deklaruar si dhurata me rastin e 5- vjetorit të djalit, K. : i) shumën 40,000 lekë nga babai i saj, z. H. P.; dhe ii) shumën 60,000 lekë nga babai bashkëshortit, z. R. M..

**30.9.** Në DPV/2015 subjekti ka deklaruar shtim në vlerë shumën 2,055 euro, në depozitën bankare ekzistuese pranë BKT-së në emër të fëmijës së mitur K. M. . Si burim krijimi të kësaj shume ka deklaruar: i) vlerat e dhuruara; ii) të ardhurat nga prodhimet bujqësore të deklaruara për vitin 2014; dhe iii) kursime page. Data e shtimit të depozitës: 28.12.2011. Në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale” subjekti ka deklaruar si dhurata me rastin e 6- vjetorit të djalit, K. : i) shumën 30,000 lekë nga babai i saj, z. H. P.; dhe ii) shumën 30,000 lekë nga babai



i bashkëshortit, z. R. M. . Gjithashtu ka deklaruar dhurata me rastin e lindjes së djalit I. : i) shumën 40,000 lekë nga babai i saj, z. H. P.; ii) shumën 50,000 lekë nga babai i bashkëshortit z. R. M.; dhe iii) shumën 30,000 lekë dhuratë nga vëllai, z. M. P. .

**31.** Në DPV/2016 subjekti ka deklaruar shtim në vlerë shumën 1,000 euro, në depozitën bankare ekzistuese pranë BKT-së në emër të fëmijës së mitur K. M. . Si burim krijimi të kësaj shume ka deklaruar: i) vlerat e dhuruara në vitin 2016; dhe ii) kursime nga paga.

Gjithashtu, nga verifikimi i DPV-ve vjetore, konstatohet se subjekti ka deklaruar në vazhdimësi si shtesë pasurie interesat e përfituara ndër vite nga kjo depozitë.

### Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

**32.** Banka Kombëtare Tregtare<sup>42</sup> konfirmon se në emër të djalit të subjektit K. M. është e hapur një llogari në monedhën euro, në datën 31.12.2010. Nga lëvizjet e llogarive pranë kësaj banke konstatohet se bashkëshorti i subjektit ka kryer depozitim dhe parë *cash* fillimisht në shumën 2,000 euro, në datën 31.12.2010, të cilat janë investuar në depozitë me afat dhe si rezultat i shumave të shtuara nga vit në vit nga depozitimet e kryera *cash*, nga interesat e përfituara për periudhën 2010 - 2016, për rrjedhojë gjendja e llogarisë në datën 31.12.2016 ka qenë 13,581 euro, pasqyruar në mënyrë analitike në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 3.**

| Viti | Shtesa <i>cash</i> gjatë vitit<br>lekë | Data e depozitimit | Gjendja fund viti lekë |
|------|--|--------------------|------------------------|
| 010  | 277 620                                | 31.12.2010         | 277 620                |
| 2011 | 275 580                                | 09.12.2011         | 553 200                |
| 2012 | 285 120                                | 11.12.2012         | 838 320                |
| 2013 | 283 360                                | 18.12.2013         | 1 121 680              |
| 2014 | 279 420                                | 19.12.2014         | 1 434 867              |
| 2015 | 250 245                                | 28.12.2015         | 1 692 682              |
| 2016 | 133 708                                | 29.12.2016         | 1 837 102              |

**32.1.** Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj pasurie ndër vite, në deklaratat periodike vjetore të depozituara në ILDKPKI, si edhe gjendjen e saj në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting”.

### Të ardhurat e deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie

#### Të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore (prindërit e subjektit dhe të bashkëshortit)

**32.2.** Siç u theksua edhe më sipër, lidhur me të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga shitja e produkteve bujqësore, në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se *...pjesa tjetër e mbetur nga shuma totale 1,515,000 lekë, vlera 965,000 lekë është depozituar periodikisht në llogarinë e hapur për fëmijën e mitur K. M. pranë BKT-së, si një nga burimet e depozitimit të llogarive, përkatësisht në vitet 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015. Pra, këto të ardhura u janë shtuar të ardhurave të tjera që kanë patur ndër vite, të deklaruara rregullisht dhe pavarësisht se nuk është përdorur termi kursim për këtë shumë, logjika e përdorur në plotësimin e secilës deklaratë është pikërisht që kjo shumë është konsideruar si kursim, duke u deklaruar si një prej burimeve të krijimit të depozitës së fëmijës K., të cilat depozitoheshin në vitin pasardhës. Kjo shumë në asnjë rast nuk është përdorur për*

<sup>42</sup> Shkresa nr. \*\*\*\* prot., datë 17. 8.2020.

*asnjë lloj shpenzimi tjetër, por destinacioni i saj ka qenë depozitimi në llogari, në funksion të arsimimit të fëmijës K. .*

**32.3.** Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore konstatohet se për vitet 2010 – 2014 vlerat e të ardhurave nga shitja e produkteve bujqësore janë deklaruar në rubrikën ku deklarohen shtesat/pakësimet e pasurive vjetore. Po ashtu, vetë subjekti në deklaratimet e bëra ka referuar si burim shtese të depozitës në emër të djalit të ardhurat e përfituara nga shitja e produkteve bujqësore në vitin paraardhës, të deklaruara në DPV-në paraardhëse.

**32.4.** Pra, nisur nga vetëdeklarimet e bëra në ILDKPKI, në kuptim të parashikimeve të bëra në pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si edhe vlerësimin të tyre në harmoni me deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet pyetësorëve të dërguar nga Komisioni, rezultoi se të ardhurat e deklaruara për vitet 2010 – 2014, me burim krijimi shitjen e produkteve bujqësore, janë shtesa pasurie të secilit vit përkatës, të cilat janë pakësuar plotësisht në vitin pasardhës.

**32.5.** Gjithsesi, për këto të ardhura të deklaruara të përfituara si pjesë takuese nga shitja e produkteve bujqësore rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të dokumentuar të ardhurat e përfituara dhe pagesën e detyrimeve përkatëse mbi këto të ardhura, deklaruar si pjesë takuese nga shitja e prodhimeve bujqësore.

**32.6. Kursime nga pagat:** lidhur me të ardhurat nga punësimi i subjektit dhe i bashkëshortit në periudhën e krijimit të depozitës dhe të shtesave të kryera në të për periudhën 2010-2016, Komisioni iu referua vërtetimeve të pagave nga institucionet përkatëse, si dhe lëvizjeve të llogarive bankare, ku janë kredituar pagat e përfituara gjatë kësaj periudhe nga subjekti dhe bashkëshorti.

#### **Dhurata nga gjyshërit respektivë të fëmijës për ditëlindje e festa të ndryshme ndër vite**

**32.7.** Subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore të depozituara në ILDKPKI ka deklaruar në vazhdimësi vlera monetare të dhuruara nga familjarët për periudhën 2009-2016, në total shumën 800,000 lekë, të pasqyruara në mënyrë të përmbledhur në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 4.**

| Viti i deklaramit                  | 2009    | 2010   | 2011   | 2012   | 2013   | 2014    | 2015    | 2016   | Total                     |
|------------------------------------|---------|--------|--------|--------|--------|---------|---------|--------|---------------------------|
| a) shuma e dhuruar nga babai i SR  | 10,000  | 50,000 | 50,000 | 40,000 | 35,000 | 40,000  | 70,000  | 15,000 | 400,000                   |
| b) shuma e dhuruar nga vëllai i SR |         |        |        |        |        |         | 30,000  | 20,000 | 50,000                    |
| c) shuma e dhuruar nga vjehri      | 60,000  | 30,000 | 40,000 | 30,000 | 35,000 | 60,000  | 80,000  | 15,000 | 350,000                   |
| Totali                             | 160,000 | 80,000 | 90,000 | 70,000 | 70,000 | 100,000 | 180,000 | 50,000 | (a+b+c)<br>80,000<br>lekë |

**32.8.** Në zbatim të pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, familjarët, të cilët kanë dhuruar vlera monetare, bëjnë pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, që kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë. Bazuar në parimin e proporcionalitetit, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë krijuar shumave të dhuruara.

Subjekti i rivlerësimit deklaroi se<sup>43</sup>...*si burim për dhurimin e këtyre shumave kanë qenë kursimet ndër vite, të ardhurat nga prodhimet e tokës bujqësore të përfituara nga ligji “Për tokën”, si edhe të ardhurat nga pagat dhe pensionet e tyre.*

**32.9.** Krahas dokumentacionit të referuar më sipër, në analizimin e të ardhurave nga produktet bujqësore në trajtimin e pasurisë nr. 1, në mbështetje të deklarimit të saj, subjekti ka depozituar si prova të tjera dokumentet si më poshtë:

- i. vërtetim nga DRSSH-ja Korçë<sup>44</sup> i datës 19.10.2020, nëpërmjet të cilit konfirmohet se z. H. P. ka përfitur pension pleqërie me masë aktuale 16,219 lekë, pension i cili ka nisur të paguhet nga data 8.12.2013 e aktualisht;
- ii. kopje e dosjes së pensionit të babait H. P., nga e cila provohet pagimi i kontributeve si i vetëpunësuar në bujqësi për periudhën 1993 -1999, 2000 dhe 2003.
- iii. vërtetim i DRSSH-së Korçë<sup>45</sup> i datës 19.10.2020, nëpërmjet të cilit konfirmohet se znj. B.P. ka përfitur pension pleqërie me masë aktuale 16,219 lekë, pension i cili ka nisur të paguhet nga data 1.11.2001 e aktualisht;
- iv. kopje e dosjes së pensionit të znj. B. P. , të lëshuar nga DRSSH-ja Korçë;
- v. certifikatën e regjistrimit të personit të tatueshëm “M. H. P.”, pajisur me NIPT/SSN \*\*\*\*\*, me adresë D\*\*\*\*, me datë lëshimi 17.10.2015;
- vi. fletëregjistrimi, printuar nga sistemi i informacionit blegtoral dhe veterinar “\*\*\*\*\*”;
- vii. situacion të fermerit, lëshuar nga Shërbimi Veterinar Korçë;
- viii. vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare, lëshuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë për të ardhurat e realizuara dhe kontributet e paguara nga znj. L. F. M. për periudhën tetor 1999 – 2016.
- ix. vërtetim i datës 24.3.2017, lëshuar nga DRSSH-ja, për trajtimin e shtetasës L. M. me pension pleqërie në masën 28.560 (njëzet e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë lekë);
- x. vërtetim<sup>46</sup> datë 21.10.2020 për trajtimin e shtetasës L.M. me pension me masë aktuale 30.184 ( tridhjetë mijë e tetëqind e katërbëdhjetë) lekë.
- xi. librezë pensioni e shtetasës L. M. , nga e cila rezulton se shuma mujore e pensionit të përfitur nga ana e saj është në masën 30.814 (tridhjetë mijë e tetëqind e katërbëdhjetë ) lekë;
- xii. librezë pensioni e shtetasit R. M. , nga e cila rezulton se shuma mujore bruto e pensionit të përfitur prej tij që nga data 5.3.2019 është në masën 14,781 (katërbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e një) lekë;
- xiii. ekstrakt i llogarisë personale të sigurimit për të punësuarit në sektorin e ndërtimit për vitin 2002-2006 (IKA), të përkthyer në gjuhën shqipe.
- xiv. deklaratë noteriale e shtetasve H. dhe B. P. <sup>47</sup>, e datës 5.8.2020, për dhurimet periodike të bëra në favor të fëmijëve të subjektit (nipërve);
- xv. deklaratë noteriale e shtetasit M. P.<sup>48</sup> e datës 5.8.2020, për dhurimet periodike të bëra në favor të fëmijëve të subjektit (nipërve);
- xvi. deklaratë noteriale e shtetasve të R. dhe L. M.<sup>49</sup> e datës 5.8.2020, për dhurimet periodike të kryera prej tyre në favor të fëmijëve të subjektit (nipërve).

**33.** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar dhe deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, rezultoi se personat e tjerë të lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për dhënien e dhuratave në vlera monetare, kjo edhe pasi, si burim

<sup>43</sup> Pyetja nr. 2 e pyetësorit nr. 2 të dërguar nga Komisioni/përgjigjet e dërguara nga subjekti.

<sup>44</sup> Vërtetim nr. \*\*\*\* prot., datë 19.10.2020.

<sup>45</sup> Vërtetim nr. \*\*\*\* prot., datë 19.10.2020.

<sup>46</sup> Vërtetim nr. \*\*\*\* prot., datë 21.10.2020.

<sup>47</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 5.8.2020.

<sup>48</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 5.8.2020.

<sup>49</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 5.8.2020.

kryesor i të ardhurave të tyre janë deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e produkteve bujqësore, për të cilat Komisioni paraprakisht ka vlerësuar se subjekti nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për të dokumentuar të ardhurat e përfituara dhe pagesën e detyrimeve përkatëse mbi këto të ardhura.

**34. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit, duke i kërkuar:**

- i. paraqitjen e argumenteve/shpjegimeve përfundimtare dhe depozitimin e provave të reja të mundshme (mbështetëse) lidhur me përfitimim të ardhurave, deklaruar si pjesë takuese nga shitja e prodhimeve bujqësore dhe pagesën e detyrimeve përkatëse që lidhen me to;
- ii. paraqitjen e argumenteve/shpjegimeve shteruese dhe depozitimin e provave të reja të mundshme (mbështetëse) për të ardhurat e përfituara nga personat të tjerë të lidhur, të cilat kanë shërbyer si burim krijimi i shumave të dhuruara ndër vite në favor të subjektit të rivlerësimit.

**Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**34.1.** Lidhur me të ardhurat e deklaruar si pjesë takuese nga shitja e produkteve bujqësore, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se *me paraqitjen e deklaratës "Vetting", si dhe gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, ka paraqitur prova direkte, të cilat provojnë faktet dhe rrethanat e mëposhtme: i) posedimin dhe pronësinë e antarëve të familjes bujqësore mbi tokat bujqësore prej vitit 1992; ii) pagimin e detyrimeve fiskale pranë pushtetit vendor dhe mospasjen e asnjë detyrimi mbi tokën bujqësore të pashlyer të personave që i kanë krijuar këto të ardhura; iii) përdorimin dhe administrimin e tokës bujqësore nga ana e kryefamiljarëve respektive dhe realizimin nga ana e tyre të kësaj veprimtarie bujqësore; iv) rendimentin e kulturave bujqësore të mbjella në periudhat e deklaruar, çmimet e tyre referuar tregut në Qarkun Korçë dhe të ardhurat e përfituara, të llogaritura nga specialist të fushës të bujqësisë; v) përfitimim të shumave respektive të deklaruar periodikisht si dhe në deklaratën "Vetting"; vi) realizimin e të ardhurave nga secili kryefamiljar dokumentuar me anë të deklaratave noteriale; dhe vii) pagimi rregullisht i taksës vendore për përdorimin e tokës bujqësore; viii) pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga kryefamiljarët deri në plotësimin e moshës për pension;*

**34.2.** Në vijim, tej provave të administruara gjatë hetimit administrativ nga Komisioni, subjekti ka depozituar dokumentacion shtesë, me anë të të cilit pretendon të provojë përdorimin në vazhdimësi të tokës bujqësore si nga babai i saj, i cili jeton në fshat, ashtu dhe nga babai i bashkëshortit të saj, i cili jeton në Tiranë, e konkretisht dokumentacionin si vijon:

- i. vërtetim i kryeplakut të fshatit D\*\*\*\*, datë 18.2.2021;
- ii. vërtetimin e kryeplakut të fshatit V\*\*\*\*, datë 18.2.2021;
- iii. deklaratë dore e shtetasit Y. V. ,datë 18.2.2021;
- iv. deklaratë dore e shtetasit B. Ç. , datë 16.2.2021.

**34.3.** Gjithashtu, duke pretenduar të provojë indirekt shitjen e disa produkteve bujqësore nga kryefamiljarët respektivë tek bashkëfshatarët apo persona të tjerë, subjekti ka depozituar disa deklarata (shkresa të thjeshta) të bëra nga shtetas të ndryshëm, si më poshtë:

- i. deklaratë dore e shtetasit E. P.;
- ii. deklaratë dore e shtetasit R. G.;
- iii. deklaratë dore e shtetasit B. Sh. datë 18.2.2021;
- iv. deklaratë dore e shtetasit L. O. e datës 17.2.2021;
- v. deklaratë dore e shtetasit S. M. .

**34.4.** Si përfundim, lidhur me këtë barrë prove të lënë nga Komisioni, subjekti ka pretenduar se gjendet në pamundësi objektive për të dokumentuar me prova direkte shitjen e këtyre produkteve

dhe vlerat konkrete të të ardhurave të realizuara nga kryefamiljarët respektivë si përfaqësues të familjes bujqësore, pamundësi e cila rezulton nga rrethanat si më poshtë:

- i. shitjet janë realizuar kohë më parë dhe në treg informal;
- ii. kjo e ardhur nuk është realizuar nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga bashkëshorti i saj. Të ardhurat e realizuara nga secili prej tyre kanë si burim pagën për shkak të ushtrimit të detyrave respektive;
- iii. kjo e ardhur është realizuar nga personat e tjerë të lidhur, kryefamiljarët respektivë H. P. dhe R. M. dhe asnjëri prej tyre nuk ka mbajtur pasqyrime për mënyrën e krijimit të këtyre të ardhurave për periudhën 2008-2015;
- iv. asnjëri prej tyre nuk ka pasur detyrimin ligjor të dokumentojë këtë veprimtari të ushtruar, e cila në çdo rast nuk rezultonte të ishte veprimtari tregtari, por fermeri.

**34.5.** Lidhur me barrën e provës për të provuar pagimin e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura, subjekti u qëndron shpjegimeve të dhëna në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, duke shpjeguar se këto janë të ardhura, të cilat nuk janë realizuar prej saj dhe bashkëshortit, por janë realizuar nga secili kryefamiljar si i vetëpunësuar në bujqësi dhe subjekti që i ka realizuar nuk ka pasur detyrim për pagimin e tatimeve mbi këto të ardhura, duke u mjaftuar të provojë se: i) disponon dhe përdor tokë bujqësore, ii) paguan kontributet si i vetëpunësuar në bujqësi.

**34.6.** Subjekti ka sqaruar se kontributet janë paguar për periudha të caktuara kohore, të cilat korrespondojnë me plotësimin e viteve të sigurimit për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë nga secili prej tyre. Pavarësisht faktit të konstatuar nga Komisioni se H. P. ka paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore si i vetëpunësuar në bujqësi për periudhën 1.10.1993 – 31.1.2000 dhe 1.1.2013 – 30.1.2013, ndërsa R. M. ka paguar kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore si i vetëpunësuar në bujqësi për periudhën 1.10.1993 – 30.9.2004 dhe 1.1.2005 – 31.12.2006, kjo nuk provon mungesën e ushtrimit prej tyre të aktivitetit si bujk në periudhat e tjera, përfshirë periudhën 2008-2015.

**34.7.** Në mbështetje të deklarimeve të saj, subjekti ka përmendur kuadrin ligjor që parashikon detyrimin e të vetëpunësuarve në bujqësi për të paguar kontributet deri në moshën për pension, në rastet kur plotësojnë kushtet për t'u siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi.

#### **Lidhur me dhurimet e deklaruara**

**34.8.** Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se shumata e dhuruara nga prindërit e saj kanë qënë simbolike dhe lehtësisht të mundshme për t'u kursyer prej tyre, duke pasur parasysh se shpenzimet për jetesë në fshatin D\*\*\*\* janë të ulëta, pasi dhe produktet kryesore i sigurojnë nga prodhimi i tokës, ndërkohë që ka aktivitet të dokumentuar si fermer edhe vëllai M. P. .

**34.9.** Ndërsa, për të ardhurat e prindërve të bashkëshortit, përveç atyre të deklaruara si burim të krijimit të dhurimit, ka deklaruar se ata kanë pasur të ardhura të tjera, të cilat rridhnin nga qiraja e ambienteve të katit të parë të banimit, me të cilat mbulonin shpenzimet e tyre për jetesë, ndërsa të ardhurat nga paga e vjehrrës L. M. , të ardhurat nga toka bujqësore dhe kursimet e tyre kanë shërbyer si burim i dhurimeve në favor të nipërve. Subjekti ka depozituar dokumentacion shtesë lidhur me masën e pensionit dhe të ardhurat e përfituara ndër vite nga pensioni, të nënës së bashkëshortit, znj. L. M. .

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

##### **Lidhur me të ardhurat e deklaruara si pjesë takuese nga shitja e produkteve bujqësore**

**35.** Pasi analizoi me objektivitet të gjitha deklaratimet e bëra dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, si edhe shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit - lidhur me të ardhurat e pretenduara si pjesë takuese nga shitja e produkteve bujqësore, Komisioni vëren se:

- i. provohet se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur zotërojnë pjesë takuese mbi tokë bujqësore, të përfituar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- ii. provohet kryerja e pagesave të taksave përkatëse për tokën bujqësore, nga kryefamiljarët e familjes bujqësore;
- iii. rezulton e provuar se dy kryefamiljarët e familjeve bujqësore figurojnë se kanë qenë të deklaruar si të vetëpunësuar në bujqësi, duke paguar kontributet përkatëse, për periudhën deri në mbushjen e moshës për pension;
- iv. këto të ardhura janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur. Në këtë kuptim në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 deklaratimet e bëra vlerësohen si provë, duke i dhënë peshë në harmoni me provat dhe *indiciet* e tjera të administruara gjatë hetimit administrativ dhe me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit;
- v. ka *indicie* të tjera, të cilat referojnë të dhëna për zhvillimin e aktivitetit bujqësor nga të dyja familjet bujqësore respektive;
- vi. shumat e deklaruara si të përfitura nga shitja e produkteve bujqësore rezulton se janë në vlera të tilla proporcionale, të pranueshme/justifikueshme si pjesë takuese nga lënia në përdorim e tokës bujqësore, në kushtet kur krijohet bindja se kryetari apo anëtarët e familjes bujqësore kanë kryer aktivitet si të vetëpunësuar në bujqësi dhe kanë përfituar të ardhura nga ky aktivitet.

**35.1.** Në nenin 222 të Kodit Civil përcaktohet se *pronësia mbi pasurinë e anëtarëve të familjes bujqësore u përket në tërësi anëtarëve të saj, të cilët nëpërmjet punës ose të drejtave të tjera të fituara kanë kontribuar në krijimin e në mbajtjen e ekonomisë bujqësore*. Ndërsa në nenin 224 të këtij Kodi përcaktohet se *familja bujqësore përfaqësohet në marrëdhëniet pasurore me të tretët nga kryetari, i cili zgjidhet nga anëtarët e saj*.

**35.2.** Në përputhje me nenin 227 të Kodit Civil, çdo anëtar i familjes bujqësore mund të kërkojë pjesën e vet në pasurinë e familjes bujqësore. Ajo përcaktohet duke marrë parasysh sidomos: i) pasurinë që i përket tërë familjes; ii) numrin e anëtarëve të familjes; iii) kontributin e tij në vënien ose shtimin e pasurisë së familjes, duke u nisur nga sasia ose efektiviteti i këtij kontributi, si dhe nga puna dhe mjetet e dhëna në krijimin dhe mbajtjen e ekonomisë bujqësore.

**35.3.** Nga verifikimi dhe analizimi i legjislacionit tatimor, ndër vite, rezulton se të vetëpunësuarit në bujqësi (fermerët) nuk kanë pasur detyrim për regjistrimin në organin tatimor. Rezulton se për herë të parë koncepti i fermerit në legjislacionin fiskal është parashikuar në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” (ndryshimet e bëra me ligjin nr. 9848, datë 17.12.2007), aktualisht i shfuqizuar, ku në nenet 58/1, 58/2, 58/3 dhe 58/4 të këtij ligji përcaktohen skema e kompensimit të fermerëve.

**35.4.** Referuar këtyre dispozitave vërehet se përfitojnë nga skema e kompensimit fermerët, të cilët nuk janë regjistruar dhe nuk janë të detyruar të regjistrohen sipas këtij ligji, por që janë të pajisur me një kod personal të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe furnizojnë personat e tatueshëm me mallra me prejardhje nga puna e tyre në njërin nga fushat e prodhimit bujqësor e blegtoral. Në nenin 58/4 të këtij ligji përcaktohet se është blerësi (personi i tatueshëm) ai që lëshon faturë tatimore për shitësin fermer, për çdo furnizim të marrë prej tij.

**35.5.** Gjithashtu Komisioni vëren se me ligjin nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” (nenet 146 dhe 147) u është dhënë mundësia prodhuesve bujqësorë të pajisen me numër identifikimi si person i tatueshëm nga Drejtoria Rajonale Tatimore ku ushtron aktivitet, kjo për efekt të përfshirjes së tyre në skemën e kompensimit të TVSH-së, por gjithsesi, pa iu nënshtruar detyrimit për deklaram, sipas nenit 106 të këtij ligji.

**35.6.** Në këtë kuptim, me ndryshimet ligjore të bëra në vitin 2014, fermerët, të cilët shesin produktet e tyre te sipërmarrësit (tregtarë), janë të detyruar të regjistrohen dhe të pajisen me NIPT. Gjithsesi, fermeri i regjistruar nuk ka asnjë përgjegjësi tatimore dhe, për rrjedhojë asnjë detyrim për të paguar. Pra, fermerët, të cilët shesin produktet e tyre tek individë (subjekte të paregjistruar) nuk kanë detyrimin për t'u regjistruar dhe për t'u pajisur me NIPT.

**35.7.** Në prapësimet e saj, në referim të deklarimeve të dhëna nga kryefamiljarët respektivë, subjekti ka shpjeguar se produktet bujqësore janë shitur tek individë (bashkëfshatarë dhe persona të tjerë)<sup>50</sup>, si edhe disa produkte specifike janë shitur të blerës të ndryshëm që vinin nga zona e Myzeqesë, por të paidentifikuar.

**35.8.** Komisioni vlerëson se e vetnja mundësi që i vetëpunësuarit në bujqësi (fermeri) ka/ka pasur për të provuar me dokumentacion justifikues ligjor faktin e shitjes së produkteve bujqësore dhe vlerën e të ardhurave të përfituara nga shitja, është rasti i përfshirjes së tyre në skemat e kompensimit, pra, shitjes së produkteve bujqësore në subjekte tregtare të regjistruara.

**35.9.** Gjithashtu, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, të ardhurat e realizuara nga shitja e produkteve bujqësore nga të vetëpunësuarit në bujqësi (fermerët) nuk janë parashikuar si të ardhura të tatueshme.

**36.** Nga analizimi në harmoni i parashikimeve të bëra në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” me parashikimet e bëra në ligjet “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” ndër vite (të referuara si më sipër në këtë vendim) Komisioni arrin në konkluzionin se të ardhurat e përfituara nga shitja e produkteve bujqësore apo blektorale nga aktiviteti i të vetëpunësuarit në bujqësi, fermerit (të cilët nuk janë regjistruar dhe nuk janë të detyruar të regjistruar në organin tatimor), janë të ardhura të cilat nuk i nënshtrohen pagesës së detyrimeve tatimore.

**36.1.** Lidhur me pagesën e kontributeve si të vetëpunësuar në bujqësi, në nenin 9 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” përcaktohet se *personat e vetëpunësuar në bujqësi janë të detyruar të paguajnë kontribut për barrë lindje dhe për pensione.* Ndërsa, në rregulloren nr. 2, datë 2.12.2008 “Për kontributet e sigurimeve shoqërore”<sup>51</sup> përcaktohet se plotësojnë kushtet për t'u siguruar, të vetëpunësuarit në bujqësi, të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç deri në moshën për pension, sipas nenit 92 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

**36.2.** Sipas dispozitave të mësipërme, të vetëpunësuarit në bujqësi mbartin detyrimin për derdhjen e kontributeve, duke nisur nga mosha 16 vjeç deri në moshën e daljes në pension, pra, sigurimi shoqëror dhe shëndetësor në bujqësi është i detyrueshëm deri në moshën e daljes në pension.

**36.3.** Bazuar në rrethanat e mësipërme, si edhe shpjegimet dhe provat e administruara/depozituara nga subjekti, Komisioni krijoi bindjen se personat e tjerë të lidhur kanë kryer aktivitet si të vetëpunësuar në bujqësi (fermerë) dhe kanë realizuar të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore.

**36.4.** Gjithsesi, Komisioni çmon se në përputhje me kuadrin ligjor që rregullon aktivitetin e fermerëve, në kushtet kur nuk u provua se personat e tjerë të lidhur (si fermerë) kanë shitur produktet e tyre bujqësore në subjekte të regjistruar dhe se nuk kanë qenë përfitues të skemave të kompensimit, janë bindëse shpjegimet e subjektit se gjendet në pamundësi objektive për të dokumentuar me prova direkte shumën e të ardhurave të realizuara nga shitja e produkteve bujqësore.

---

<sup>50</sup> Ka depozituar disa deklarata të blerësve (shkresa të thjeshta).

<sup>51</sup> Të dalë në mbështetje e zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

**36.5.** Si konkluzion, trupi gjykues çmon se lidhur me deklarin e këtyre të ardhurave subjekti nuk gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm në përputhje me parashikimet e bëra në pikën 3 të nenit 61 të këtij ligji.

### **Lidhur me dhurimet e deklaruar dhe burimin e krijimit të tyre**

**36.6.** Nga verifikimi i të ardhurave të personave të tjerë të lidhur të provuara me dokumentacion justifikues ligjor rezulton se, shuma totale e dhurimeve nga z. R. M. përbën 11% të të ardhurave të bashkëshortes së tij për periudhën kur ato janë kryer. Ndërsa, shuma totale e dhurimeve nga z. H. P. përbën 25 % të të ardhurave të tij dhe bashkëshortes për periudhën kur ato janë kryer. (referohu 2 tabelave të mëposhtme).

#### **Tabela nr. 5.**

(Dhurimet, të ardhurat e familjes M. ); raporti dhurime/të ardhura = 11%.

| Viti i deklarimit                      | 2009    | 2010    | 2011    | 2012    | 2013    | 2014    | 2015    | 2016    | Totali    |
|--|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|-----------|
| Shuma e dhuruar nga vjehri dhe vjehrra | 60,000  | 30,000  | 40,000  | 30,000  | 35,000  | 60,000  | 80,000  | 15,000  | 350,000   |
| Paga e vjehrrës                        | 340,241 | 110,433 | 0       | 314,041 | 553,524 | 657,583 | 558,369 | 266,850 | 2,801,041 |
| Pension invaliditeti i vjehrrës        |         | 47,132  | 141,396 | 35,349  |         |         |         |         | 223,877   |
| Pension pleqërie i vjehrrës            |         |         |         |         |         |         |         | 164,912 | 164,912   |

#### **Tabela nr. 6.**

(Dhurimet, të ardhurat e familjes P. ); raporti dhurime/të ardhura = 25%.

| Viti i deklarimit                          | 2009    | 2010    | 2011    | 2012    | 2013    | 2014    | 2015    | 2016    | Totali    |
|--|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|-----------|
| Shuma e dhuruar nga babai, nëna dhe vëllai | 100,000 | 50,000  | 50,000  | 40,000  | 35,000  | 40,000  | 100,000 | 35,000  | 450,000   |
| Pensioni i nënës                           | 142,908 | 150,396 | 156,696 | 161,874 | 166,854 | 171,288 | 173,828 | 176,027 | 1,299,871 |
| Pensioni i babait                          |         |         |         |         | 10,867  | 171,288 | 173,828 | 176,027 | 532,010   |

**36.7.** Në përputhje me qëndrimin e mbajtur nga Kolegji i Apelimit<sup>52</sup>, Komisioni vlerëson se për sa kohë që personat e tjerë të lidhur nuk janë subjekte rivlerësimi, analiza dhe vlerësimi i pasurisë së tyre duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhënë hua apo dhuruar dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm, referuar rasteve konkrete e rrethanave specifike të tyre, përveç rasteve të ekzistencës së dyshimeve për pasuri të fshehura në emër të personave të tjerë të lidhur.

**36.8.** Në vijim të këtij arsyetimi, Komisioni çmon se në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur.

<sup>52</sup> Vendimet e Kolegjit nr. 15/2019 (JR), datë 17.7.2019 dhe nr. 20/2019 (JR), datë 31.7.2019.



**36.9.** Pasi analizoi me objektivitet të gjitha deklaratimet e bëra dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, si edhe shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, lidhur me dhurimet e deklaruara, Komisioni vlerëson se personat e tjerë të lidhur kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme të cilat mundësojnë plotësisht dhurimin e këtyre vlerave monetare.

**37.** Trupi gjykues arriti në këtë konkluzion, pasi analizoi vlerat e dhurimeve ndër vite, qëllimin e këtyre dhurimeve, si edhe faktin se personat e tjerë të lidhur mund të kenë përdorur të ardhura të tjera, të cilat nuk i provojnë me dokumentacion ligjor provues (sipas deklaratimit të bërë, të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore apo nga qiradhënia) për mbulimin e shpenzimeve të tyre.

**Vlerësimi përfundimtar i Komisionit lidhur me ligjshmërinë e krijimit të dy depozitave objekt vlerësimi: i) depozitës në vlerën 2,821,939 lekë, dhe ii) depozitës në shumën 13,581 euro.**

**38.** Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burim krijimi të depozitës me vlerë 2,821,939 lekë: i) të ardhurat nga prodhimet bujqësore; ii) kursime nga pagat e saj dhe bashkëshortit; si dhe iii) të ardhurat nga shitja e automjetit “Mercedes – Benz”, tipi “250 D”, me kontratën nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 25.5.2016. Ndërsa si burim krijimi të depozitës me vlerë 13,581 euro ka deklaruar: i) të ardhurat nga prodhimet bujqësore; ii) kursimet nga pagat; si dhe iii) dhurata nga gjyshërit respektivë të fëmijës për ditëlindje e festa të ndryshme ndër vite.

**38.1.** Referuar analizës financiare të kryer nga Komisioni<sup>53</sup>, edhe në kushtet e mospërfshirjes në zërin e të ardhurave, të ardhurat e deklaruara të përfituara si pjesë takuese nga shitja e produkteve bujqësore, rezultojnë se për vitet 2005<sup>54</sup> – 2016 balanca totale negative e fondeve paraqitet në total në vlerën -196,836 lekë, e konkretisht viti 2008 në - 54,741 lekë dhe viti 2011 në -142,094 lekë.

**38.2.** Në këtë këndvështrim rezultojnë se subjekti i rivlerësimit justifikon krijimin e këtyre depozitave me burimet e tjera të deklaruara në deklaratën “Vetting” edhe pa u konsideruar të ardhurat e deklaruara të përfituara si pjesë takuese nga shitja e produkteve bujqësore.

**38.3.** Vlen të theksohet këtu se analiza financiare mund të ketë një marzh gabimi në elementet të cilat vlerësohen. Ajo shërben si një indikator për verifikimin e të ardhurave të ligjshme, asetëve dhe shpenzimeve për një periudhë të caktuar kohore. Por, çdo analizë financiare nga vetë natyra e saj është e përafërt dhe jo absolute.

**38.4.** Për më tepër, në analizën e kryer më sipër, Komisioni nuk përjashtoi mundësinë e përfitimit të të ardhurave të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur si pjesë takuese nga shitja e produkteve bujqësore. Në këtë kuptim, në kushtet kur Komisioni krijoi bindjen se familjet respektive kanë kryer aktivitet bujqësor dhe kanë gjeneruar të ardhura, për rrjedhojë vlerësohet se këto të ardhura janë përfituar nga anëtarët e këtyre familjeve bujqësore.

**38.5.** Komisioni çmon se të ardhurat nga shitja e produkteve bujqësore, të deklaruara nga subjekti në deklaratat periodike vjetore, janë të ardhura të gjeneruara nga familja bujqësore, të cilat nuk i nënshtrohen regjimit tatimor dhe në kuptim të nenit 227 të Kodit Civil çdo anëtar i familjes bujqësore mund të kërkojë dhe të marrë pjesën e tij takuese mbi këto të ardhura, në përputhje me kontributin e dhënë prej tij.

**38.6.** Në këndvështrim të faktit se të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga shitja e produkteve bujqësore janë në një masë të tillë të pranueshme, proporcionale, të shpërndara ndër vite, është bindës deklarimi i subjektit mbi këto të ardhura dhe Komisioni vëren se, në rast të përfshirjes së tyre në analizën financiare, përmbysen balanca negative e fondeve për vitet 2008 dhe 2011.

<sup>53</sup> Tabela përmbledhëse e analizës financiare, ndodhur Aneks 1 – bashkëlidhur këtij vendimi.

<sup>54</sup> Vit në të cilin subjekti ka filluar detyrën.

**38.7.** Si konkluzion, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, trupi gjykues krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e këtyre depozitave.

### **Depozitë bankare në vlerën 200,000 lekë**

**39.** Subjekti ka deklaruar depozitë bankare në BKT në vlerën 200,027 lekë, e hapur në emër të fëmijës së mitur I. M. më 29.12.2016.

**39.1. Si burim krijimi** të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar dhuratë nga familjarët (babai i subjektit H. P., babai i bashkëshortit të subjektit R. M. dhe vëllai i subjektit M. P.) për lindjen e fëmijës I. dhe vlera të dhuruara nga familjarë të tjerë për këtë rast, ku asnjëra prej tyre individualisht nuk e kalon shumën 10,000 lekë.

### **Deklarimi i kësaj pasurie në vite**

**39.2.** Nga verifikimi i DPV/2016 konstatohet se subjekti ka deklaruar këtë pasuri *depozitë bankare në vlerën 200,027 lekë pranë BKT-së, e hapur në emër të fëmijës së mitur I. M. më 29.12.2016. Burimi i krijimit dhuratë nga familjarët (babai i subjekti H. P., babai i bashkëshortit të subjektit R. M. dhe vëllai i subjektit M. P.) për lindjen e fëmijës I. dhe vlera të dhuruara nga familjarët e tjerë për këtë rast, ku asnjëra prej tyre individualisht nuk e kalon shumën 10,000 lekë.*

**39.3.** Gjithashtu, në DPV/2016, në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale” subjekti ka deklaruar vlera monetare të dhuruara për 1-vjetorin e djalit I. : i) shumën 15,000 lekë dhuruar nga babai i saj, H. P.; ii) shumën 15,000 lekë dhuruar nga babai i bashkëshortit, R. M.; dhe iii) shumën 20,000 lekë dhuruar nga vëllai i saj, M. P. .

### **Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**39.4.** BKT-ja<sup>55</sup> konfirmon se në emër të djalit të subjektit I. M. të subjektit të rivlerësimit është e hapur një llogari në monedhën lekë, në datën 29.12.2016. Referuar lëvizjeve të llogarive pranë kësaj banke bashkëshorti i subjektit ka kryer depozitim e parë *cash* fillimisht në shumën 200,000 lekë, në datën 29.12.2016, të cilat janë investuar në depozitë me afat.

Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat e kësaj depozite.

### **Analizë e burimit të të ardhurave të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie**

#### **Vlerat monetare të dhuruara me rastin e lindjes së djalit I.**

**39.5.** Nga verifikimi i DPV/2015 konstatohet se në rubrikën “dhurata dhe trajtime preferenciale” subjekti ka deklaruar vlera monetare të dhuruara me rastin e lindjes së fëmijës I. : i) shumën 40,000 lekë nga babai i saj, z. H. P.; ii) shumën 50,000 lekë dhuruar nga babai bashkëshortit, z.R.M.; iii) shumën 30,000 lekë nga vëllai i saj, M. P. ; dhe iv) shumën 160,000 lekë nga familjarë dhe shokë, duke shpjeguar se asnjëri prej tyre individualisht nuk e ka kaluar shumën 10,000 lekë.

**39.6.** Në DPV/2016 subjekti ka deklaruar si vlera monetare të dhuruara nga familjarët e saj me rastin e 1-vjetorit të djalit I., në total shumën 50,000 lekë.

**39.7.** E pyetur nga Komisioni<sup>56</sup> në lidhje me deklarin e dhurimeve, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në DPV/2015 janë deklaruar dhurimet e marra për lindjen e fëmijës së dytë I. duke përfshirë të gjitha dhuratat e bëra në *cash* nga të afërm e familjarë, shuma të cilat në mënyrë individuale nuk e kalonin vlerën 10.000 lekë të detyrueshme për deklarim, por që nga mbledhja e totalit të tyre ishte një vlerë e përcaktuar, e cila nuk u shpenzua prej tyre, por u depozitua në llogari të fëmijës I., duke u deklaruar në DPV/2016. Ndërsa shumat e dhuruara për 1-vjetorin e

<sup>55</sup> Shkresa nr. \*\*\*\* prot., datë 17.8.2020.

<sup>56</sup> Pyetësori nr. 2.

*tij, të cilat e kalonin vlerën ligjore të detyrueshme për deklarim, në zbatim rigoroz të ligjit dhe në funksion të transparencës janë deklaruar rregullisht në DPV-të periodike dhe atë “Vetting”, ku në këtë të fundit janë pasqyruar si burim për krijimin e depozitës së fëmijës I. .*

**39.8.** Sa më sipër rezulton se në DPV/2015 subjekti ka deklaruar shumat e dhuruara për lindjen e djalit I., por nuk ka deklaruar shtesë pasurie në formë likuiditetesh *cash*, me burim këto vlera monetare të dhuruara dhe, si rrjedhim, rezulton se ato nuk mund të kenë shërbyer si burim për krijimin e depozitës me vlerë 200,000 lekë (krijuar në datën 29.12.2016).

**39.9.** Pas kalimit të barrës së provës, me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse në shpjegimet e dhëna për krijimin e depozitës në BKT, duke pranuar konstatimin e Komisionit, por duke sqaruar se kjo pasaktësi ka ardhur si pasojë e kuptimit të mënyrës së plotësimit të deklaratës periodike vjetore prej saj. Subjekti ka pretenduar se kjo shumë është mbajtur *cash* në shtëpi gjatë vitit 2015, madje në arkën e kursimit të fëmijës dhe është depozituar në bankë në vitin 2016.

**40.** Pas analizimit të provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se kjo pasaktësi nuk mund të vlerësohet si deklarim i pamjaftueshëm në kuptim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë subjekti ka deklaruar në vitin pasardhës destinacionin e këtyre dhurimeve, duke nënkuptuar indirekt se shumat e dhuruara ka qenë si gjendje likuiditetesh *cash* në vitin paraardhës, pavarësisht mosdeklarimit në mënyrë eksplicite të tyre me këtë emërtim. Për më tepër që Komisioni vëren se në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj depozite, pikërisht shumat e dhuruara për lindjen e fëmijës (viti i lindjes 2015).

**40.1.** Lidhur me mundësinë financiare të personave të tjerë të lidhur (babait të saj dhe të bashkëshortit), Komisioni verësoi se ato kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të mundësuar plotësisht kryerjen e dhurimeve të deklaruara nga subjekti. Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit provues të depozituar nga subjekti i rivlerësimit rezulton se vëllai i saj, z. M. P., ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të mundësuar dhurimin e shumës 30,000 lekë.

**40.2.** Ndërsa, lidhur me shumën 160,000 lekë të deklaruar si të akumuluar si rezultat i dhurimeve nga familjarë të tjerë, por secili prej tyre individualisht nuk e kalon shumën 10,000 lekë, vlerësohet se nuk mund të jetë objekt verifikimi nga Komisioni, pasi në përputhje me germën “f” të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, nuk deklarohen dhurata ose trajtim preferencial kur vlera e tyre është më e vogël se 10 000 (dhjetë mijë) lekë.

**40.3.** Komisioni vëren se, edhe nëse nuk përfshihen në analizën financiare të vitit 2016 këto vlera të deklaruara si të dhuruara në vitin 2015 dhe si burim krijimi i depozitës objekt vlerësimi, gjithsesi viti 2016 paraqitet me balancë pozitive fondesh.

**40.4.** Trupi gjykues vlerëson se pasaktësia në deklarim nuk krijon pasoja në këtë proces dhe gjithashtu krijon bindjen se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e kësaj llogarie depozite.

### **Pasuria në përdorim, e llojit “apartament banimi”<sup>57</sup>**

<sup>57</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneksi \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së): i) certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*\*\*, datë lëshimi 7.6.2016; ii) kartelë pasuri për objektin 4+1 kat; iii) formularin e vetëdeklarimit për legalizim nr. \*\*\*\* prot., datë 15.4.2016 dhe hata treguese e regjistrimit; iv) formularin e vetëdeklarimit për legalizim nr. \*\*\*\* prot., datë 17.3.2005; v) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 22.9.2015 i Njësisë Bashkiake nr. \*\*, për depozitimin e dokumentacionit për legalizim nga z. R. M. ; dhe v) kontratë huapërdorjeje nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 14.10.2016.

**41.** Subjekti ka deklaruar se ka në përdorim pasurinë e llojit “apartament banimi”, formalizuar për efekt dokumentacioni në bazë të kontratës së huapërdorjes të datës 14.10.2016, ndodhur në katin e tretë të banesës private 4 + 1 kat, me sipërfaqe ndërtimi 85,4 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe trualli 150 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, Njësia Bashkiake nr. \*\*, Tiranë, regjistruar në pronësi të prindërve të bashkëshortit, përfituar prej tyre në bazë të lejes së legalizimit të datës 15.4.2016, në bazë të vetëdeklarimit të vitit 2005, viti i ndërtimit 1999.

**41.1. Deklarimi i kësaj pasurie në vite:** nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara ndër vite në ILDKPKI konstatohet se subjekti ka deklaruar si adresë ku është e regjistruar në gjendje civile apo si adresë banimi, adresë që përkon me vendndodhjen e kësaj pasurie.

**41.2. Konkluzioni i ILDKPKI-së për me këtë pasuri:** mungon dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me mundësinë financiare të prindërve të bashkëshortit, për ndërtimin e objektit 4 kate + 1 kat nëntokë, në rr. “\*\*\*\*\*”, nr. \*\*, Njësia Bashkiake nr. \*\*, Tiranë, pasi nga institucionet përkatëse nuk konfirmohet që të kenë pasur aktivitet privat të regjistruar në emër të tyre.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**41.3.** ASHK-ja<sup>58</sup> konfirmon se në emër të personit tjetër të lidhur, z. R. M., ka leje legalizimi nr. \*\*\*\*, datë 15.4.2016, godinë banimi 4 kate + 1 kat nëntokë. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tirana Veri<sup>59</sup> dhe Drejtoria Vendore Tirana Jug<sup>60</sup>, si edhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti me dorëzimin e deklaratës “Vetting” dhe gjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, konstatohet se:

- i. në datën 19.6.1998 z. R. M. ka blerë<sup>61</sup> pasurinë e llojit “truall”, me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, pranë Qytetit Studenti;
- ii. në datën 4.1.2004 z. R. M. ka lidhur kontratë kapari<sup>62</sup>, sipas së cilës ka rënë dakord që t’i shesi shtetasit S.B., apartamentin me sipërfaqe 107 m<sup>2</sup>, për vlerën 5,000,000 lekë, ndodhur në katin e katërt të objektit/banesës në rrugën “\*\*\*\*\*”, ndërtuar në truallin prej 150 m<sup>2</sup> në pronësi të z. R. M., regjistruar në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*\*, datë 29.6.1998. Në këtë kontratë është përcaktuar vlera e kaparit të paguar në datën e përpilimit të marrëveshjes, në shumën 4,000 euro;
- iii. në datën 2.7.2004, nëpërmjet deklaratës noteriale<sup>63</sup>, z. R. M. dhe kapardhënësi z. S.B. kanë deklaruar se janë likuiduar me njëri-tjetrin për të gjithë shumën 5,000,000 lekë, për vlerën e apartamentit;
- iv. në datën 17.3.2005 është vetëdeklaruar për legalizim<sup>64</sup> nga z. R. M. pasuria e llojit “banesë 4-katëshe”, me sipërfaqe trualli 150 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 85.4 m<sup>2</sup>.
- v. referuar këtij formulari konstatohet se z. R. M. ka deklaruar si datë/vit ndërtimi, 6.8.1999.
- vi. në datën 15.4.2016 është nxjerrë leja e legalizimit<sup>65</sup> në emër të z. R. M., për objektin “godinë banimi 4 kate + 1 nëntokë”, me sipërfaqe ndërtimi 85.4 m<sup>2</sup>, kati nëntokë 20.3 m<sup>2</sup>, kati përdhe 85.4 m<sup>2</sup>, kati i parë 112.5 m<sup>2</sup>, kati i dytë 112.5 m<sup>2</sup>, kati i tretë 112.5 m<sup>2</sup>.
- vii. në datën 7.6.2016 pasuria “godinë banimi 4 kate + 1 nëntokë”, si më sipër, është regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në emër të z. R. M.;
- viii. në datën 14.10.2016, me anë të kontratës së huapërdorjes<sup>66</sup>, kati i 3-të i banimit i lihet në përdorim subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj;

<sup>58</sup> Shkresa nr. \*\*\*\* prot., datë 31.8.2020.

<sup>59</sup> Shkresa nr. \*\*\*\* prot., datë 7.10.2020.

<sup>60</sup> Shkresa nr. \*\*\*\* prot., datë 8.1.2021.

<sup>61</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 19.6.1998

<sup>62</sup> Kontratë kapari nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 4.1.2004, redaktuar nga noteri publik znj. L. Ll.

<sup>63</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\*\* rep., datë 2.7.2004, redaktuar nga noteri publik znj. L. Ll. .

<sup>64</sup> Formulari i vetëdeklarimit për legalizim nr. \*\*\*\* prot., datë 15.3.2005.

<sup>65</sup> Leje legalizimi nr. \*\*\*\*, datë 15.4.2016.

<sup>66</sup> Kontrata e huapërdorjes me nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 14.10.2016.

ix. në datën 14.7.2017 është përpiluar kontrata e shitjes<sup>67</sup>, sipas së cilës z. R. M. i ka shitur z. S.B., apartamentin me sipërfaqe prej 112.5 m<sup>2</sup>, sipas likuidimit të deklaruar mes palëve në deklaratën noteriale të vitit 2004.

**41.4.** E pyetur lidhur me adresat e banimit ndër vite dhe mbi pronësinë e tyre, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se<sup>68</sup> *ka banuar së bashku me bashkëshortin A. M. në adresën: Minibashkia nr. \*\*, rruga “\*\*\*\*\*”, rriemërtuar rruga “\*\*\*\*\*”, Qyteti Studenti, Tiranë, apartament banimi kati i 3-të i objektit shtëpi banimi, të ndërtuar nga prindërit e bashkëshortit R. dhe L. M. i vetëdeklaruar prej babait të bashkëshortit R. M. në formularin e legalizimit datë 17 mars 2005, ndërtim i viteve 1999. Ky apartament (kati nr. \*\*), u është lënë në përdorim pa kundërshtim, të cilët përdorin pa ndërprerje 2 katet e tjera të banimit. Kjo pasuri e prindërve të bashkëshortit në vitin 2016 është regjistruar në ZRPP-në Tiranë me nr. \*\*\*\* pasurie.*

**41.5.** Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit dokumentet: i) deklaratën noteriale<sup>69</sup>, datë 5.8.2020 të shtetave R. dhe L. M., të cilët provojnë faktin e deklaruar për përdorimin prej tyre të këtij ambienti; ii) vetëdeklarim për legalizim i datës 17.3.2005; dhe iii) vërtetimin e Njësisë Bashkiake nr. \*\*, me nr. \*\*\*\* prot., datë 22.9.2015.

**41.6.** E pyetur nga Komisioni në lidhje periudhën/kohën, vlerën e ndërtimit të banesës private dhe në mënyrë të veçantë apartamentit në përdorim nga subjekti, si edhe për burimin e të ardhurave të familjarëve të bashkëshortit që kanë shërbyer për ndërtimin/krijimin e kësaj pasurie, të shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor, subjekti i rivlerësimit deklaroi se<sup>70</sup> *ka lidhur martesë me bashkëshortin A. M. më 10.3.2005<sup>71</sup>, ndërsa ka filluar detyrën e gjyqtarës në tetor të vitit 2005, pas disa muajsh nga martesja dhe pasi ndërtimi i këtij objekti kishte përfunduar në fund të vitit 2004, për rrjedhojë nuk ka asnjë kontribut të asnjë natyre në krijimin e kësaj pasurie, të asnjë kati të saj, përfshi katin e 3- të banimit të cilën prindërit e bashkëshortit ua kanë lënë atyre në përdorim. Nisur nga fakti se ndërtimi i kësaj banese ka ndodhur para faktit juridik të lidhjes së martesës çdo e dhënë rreth kohës së ndërtimit, vlerës dhe të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie ka si burim origjinal deklaratimet noteriale, si dhe dokumentacionin që prindërit e bashkëshortit disponojnë, duke mos qenë ata vetë ndonjëherë subjekt të ligjit nr. 9049/2003, për rrjedhojë nuk kanë pasur detyrimin për të ruajtur dhe dokumentuar çdo veprim juridik apo fakt me vlerë provuese lidhur me këtë ndërtim. Madje, në kohën e kryerjes së këtij ndërtimi, as bashkëshorti A. M. nuk ka qenë subjekt deklarimi i të ardhurave dhe i kontrollit të pasurisë, detyrim i cili ka lindur për shkak të fillimit të detyrës së saj si gjyqtare pas lidhjes së martesës së tyre.*

**41.7.** Për të mbështetur deklaratimet e bëra lidhur me këtë pasuri, krahas dokumenteve të depozituara me parë në ILDKPKI apo në përgjigje të pyetësorit nr.1, subjekti, bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, ka depozituar dokumentet si vijon:

i) aktekspertimi i ekspertës ing. R. D. , tetor 2020, në të cilin referohet periudha e ndërtimit dhe punimet e kryera për objektin “godinë banimi 4 kate + 1”;

ii) 2 (dy) deklarata noteriale<sup>72</sup> të shtetasit R. M., nëpërmjet të cilave deklaroi për periudhën e ndërtimit të këtij objekti, burimin e krijimit të pasurisë “truall + godinë banimi”;

iii) kontratën e shitblerjes së truallit<sup>73</sup>, datë 19.6.1998, sipas së cilës z. R. M. ka blerë truallin me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup> mbi të cilin është ngritur godina e banimit, në shumën 750,000 lekë;

<sup>67</sup> Kontratë shitjeje nr. \*\*\*\* rep., nr \*\*\*\* kol., datë 14.07.2017.

<sup>68</sup> Përgjigjet e pyetësorit nr. 1.

<sup>69</sup> Deklaratë noteriale nrr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 5.8.2020.

<sup>70</sup> Pyetësori nr. 2.

<sup>71</sup> Paraqitur më parë me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, certifikatë martesë, datë akti 10.3.2005.

<sup>72</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*\* rep, nr. \*\*\*\* kol., datë 21.10.2020 dhe nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 16.10.2020.

<sup>73</sup> Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 19.6.1998.

iv) kontratë shitjeje<sup>74</sup> me rezervë, të datës 22.6.1999, për shitjen e banesës dhe truallit nga familja M\*\*\*\* në fshatin V\*\*\*\*, për vlerën 800,000 lekë.

v) vërtetim<sup>75</sup>, datë 21.1.2020 nga “ProCredit Bank”, i cili dokumenton kreditë ndër vite të marra nga prindërit e bashkëshortit, e konkretisht: i) shuma 250,000 lekë, marrë në 20.11.2000 dhe mbyllur më 28.01.2002; ii) shuma 500,000 lekë, marrë në datën 14.2.2002 dhe mbyllur më 28.8.2003; iii) shuma 600,000 lekë, marrë në datën 28.8.2003 dhe mbyllur më 3.9.2005.

vi) deklaratë noteriale<sup>76</sup> e shtetasit E.K., datë 21.10.2020, sipas të cilës ky shtetas deklaroi se ka punuar me brigadën e ndërtimit me shtetasin R. M. .

vii) vërtetim, datë 9.7.2007 nga shoqëria “\*\*\*\*”, ku referohen të dhëna punësimi për z. R. M.;

viii) deklaratë noteriale<sup>77</sup> e shtetasit E.S., datë 16.10.2020, sipas së cilës ky shtetas deklaroi se ka me qira për periudhën 2013 – 2020, një pjesë të katit të parë të objektit godinë banimi, në emër të z. R. M..

ix) deklaratë noteriale<sup>78</sup> e shtetasit L.Z., datë 16.10.2020, sipas të cilës ky shtetas deklaroi se ka me qira për periudhën 2002 – 2007, një pjesë të katit të parë të objektit godinë banimi, në emër të z. R. M..

### Vlerësimi i Komisionit

**41.8.** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit për këtë pasuri rezultoi se godina 4 kate + 1 kat nëntokë është ndërtuar nga personi tjetër i lidhur (familja e tij), z. R. M., para lidhjes së martesës së subjektit të rivlerësimit me z. A. M. dhe para fillimit të detyrës së saj si gjyqtare.

**41.9.** Si konkluzion, trupi gjyqës çmon se janë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri në përdorim dhe se nuk ka dyshime se subjekti mund të ketë kontribut në krijimin e saj.

**50. Pasuria e llojit “automjet”, e markës “Daimler Chrysler”, tipi “C220 CDI”<sup>79</sup>,** blerë në datën 5.9.2013, në emër subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, me vlerë 3,000 euro.

Konsatohet se në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

**50.1. Deklarimi i kësaj pasurie në vite:** nga verifikimi i DPV/2013 konstatohet se subjekti dhe personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, z. A. M., kanë deklaruar blerje automjeti lloji “autoveturë”, marka “Daimler Chrysler”, tipi “C 220” dhe se si burim krijimi kanë deklaruar kursimet *cash*, të deklaruara në vitin 2012 dhe kursimet nga paga.

### Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

**50.2. DPSHTRR-ja<sup>80</sup>,** konfirmon regjistrimin e këtij automjeti në emër të subjektit dhe të bashkëshortit të saj, z. A. M.. Nga verifikimi i dosjes së këtij automjeti rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur e kanë blerë<sup>81</sup> këtë automjet në datën 5.9.2013, për çmimin 3,000 euro dhe se palët janë likuiduar midis tyre dhe nuk kanë më asnjë lloj detyrimi.

<sup>74</sup> Kontratë nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 22.6.1999.

<sup>75</sup> Vërtetim nr. \*\*\*\* prot., datë 21.1.2020

<sup>76</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol datë 21.10.2020.

<sup>77</sup> Deklaratë noteriale me nr \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 16.10.2020.

<sup>78</sup> Deklaratë noteriale me nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 16.10.2020.

<sup>79</sup> Subjekti ka dorëzuar bashkëlidhur deklaratës (aneksi \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së): i) certifikatë pronësie të mjetit rrugor me targa \*\*\*\* datë 5.9.2013; ii) kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 5.9.2013 iii) leje qarkullimi në emër të A. M. dhe Marsela Pepi të datës 5.9.2013.

<sup>80</sup> Shkresa nr. \*\*\*\* prot., datë 23.07.2020.

<sup>81</sup> Kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol, datë 5.9.2013.

## Analiza e burimit të të ardhurave të deklaruara si burim për krijimin e kësaj pasurie

**50.3.** Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj, por në DPV/2013 ka deklaruar se burim krijimi i kësaj pasurie kanë shërbyer: (i) kursimet *cash* të deklaruara për vitin 2012; dhe (ii) kursime nga paga.

**50.4.** Nga verifikimi DPV/2012 konfirmohet se subjekti i rivlerësimit në rubrikën “ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit”, shtesat/pakësimet, ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash* shumën 300,000 lekë.

**50.5.** Bazuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni<sup>82</sup> rezulton se viti 2012 paraqitet me balancë pozitive fondesh dhe, si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e shumës 300,000 lekë në gjendje likuiditetesh *cash* gjatë këtij viti, të deklaruar si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi.

**50.6.** Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje si edhe deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni kreu analizën financiare me qëllim verifikimin e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për pagesën e vlerës 3,000 euro për blerjen e këtij automjeti në datën 5.9.2013, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 7.**

| <b>Aanaliza financiare 1.1.2013 – 5.9.2013</b>   |                  |
|--|------------------|
|  | <b>5.9.2013</b>  |
| <b>PASURI</b>  | <b>494,880</b>   |
| Automjeti marka “Daimler Chrysler” (D) tipi “C220 CDI”, blerë në datën 5.9.2013. Vlera 3.000 euro. | 420,630          |
| Ndryshim likuiditeti (1.1.2013 - 5.9.2013)   | 74,250           |
| Totali likuiditete - deklaruar   | 2,623,536        |
| <b>DETYRIME</b>  | <b>0</b>         |
| <b>PASURI NETO</b>   | <b>494,880</b>   |
| <b>Të ARDHURA</b>  | <b>1,159,979</b> |
| Të ardhura SR (paga) (01.01.2013-05.09.2013)   | 658,556          |
| Të ardhura nga shitja e tokës bujqësore, bashkëshorti  | 65,052           |
| Të ardhura bashkëshorti nga paga (1.1.2013 - 5.9.2013)   | 419,787          |
| Të ardhura nga interesat nga depozita bankare (ProCredit Bank) (1.1.2013-5.9.2013)                 | 16,584           |
| <b>SHPENZIME</b>   | <b>411,624</b>   |
| Shpenzime jetese (1.1.2013-5.9.2013)   | 283,980          |
| Shpenzime për pagesë qiraje SR Gjirokastër   | 102,000          |
| Shpenzime për arsimin e personit të lidhur K.M (djali) (1.1.2013 - 5.9.2013)                       | 13,200           |
| Shpenzime udhëtimi TIMS (1.1.2013 - 5.9.2013)  | 12,444           |
| <b>Rezultati Financiar</b>   | <b>253,475</b>   |

**50.7.** Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit/personi i lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e kësaj pasurie.

**51. Pasuria e llojit “gjendje likuiditetesh *cash*”, në shumën 800,000 lekë.** Konstatohet se në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

**51.1. Deklarimi në vite i kësaj pasurie:** nga verifikimi i DPV-ve të depozituara ndër vite në IDKPKI konstatohet se subjekti deklaron për herë të parë gjendje likuiditetesh *cash* në DPV-në e vitit 2011 dhe në vijim rezulton se në deklaratat periodike të viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2015 ka kryer deklarime lidhur me shtesa dhe pakësime të gjendjes së likuiditeteve *cash*.

**Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

<sup>82</sup> Tabela përmbledhëse e analizës financiare, ndodhur në aneksin 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

**51.2.** Pasi Komisioni i kërkoj shpjegime lidhur me mënyrën e deklarimit të likuiditeteve *cash*, subjekti i rivlerësimit deklaroi se<sup>83</sup> *të gjitha të ardhurat e përfituara nga pjesa e tyre mbi tokën bujqësore, janë kursyer në shtëpi, kanë qenë gjendje që u janë shtuar kursimeve cash të deklaruarra për çdo vit, të cilat kishin burim pagat dhe janë përkthyer në depozita përkatësisht shuma 550,000 lekë në llogarinë në emër të bashkëshortit A. M. pranë “ProCredit Bank” dhe e gjithë shuma tjetër 965.000 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë është kursyer dhe është depozituar periodikisht në llogarinë në BKT, në emër të fëmijës K.. Duhet të ishte më e qartë në deklarimin e kësaj shume jo vetëm si të ardhur, por duhej të përdorte edhe termin kursim të kësaj të ardhure në çdo vit deklarimi, por ka menduar se nisur nga fakti se në deklarimin e radhës e ka pasqyruar si një nga burimet e krijimit të depozitës përkatëse këtë shumë, duke e nënkuptuar faktin se kjo shumë ka qenë e kursyer në vitin e mëparshëm të deklarimit. Pra, të gjitha likuiditetet janë konsideruar nga ana e saj si kursime cash, duke u përfshirë: shuma e të ardhurave nga prodhimet bujqësore, ashtu dhe shuma e deklaruar më vete si kursim cash.*

**51.3.** Në vlerësim të deklarimeve të bëra nga subjekti, si edhe në mbështetje të analizës së kryer nga Komisioni si më sipër në këtë vendim, rezultoi se të gjitha të ardhurat e deklaruarra në rubrikën e pasurive (shtesat/pakësimet), me burim shitjen e produkteve bujqësore, janë pakësuar vitin pasardhës, duke shërbyer si burim krijimi për depozitat e krijuara. Në këtë kuptim, pavarësisht vlerësimit të saktësisë dhe mënyrës së deklarimit të bëra nga subjekti rezultoi se gjithë ato nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi i pasurisë së llojit “gjendje likuiditetesh” në vlerën 800,000 lekë, deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”.

**51.4.** Bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, të vlerësuara në harmoni me deklaratimet e bëra gjatë hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën e ecurisë së likuiditeteve *cash* ndër vite, shtesave/pakësimeve, me qëllim verifikimin e gjendjes së mundshme të këtyre likuiditeteve në fund të vitit 2016, në raport me verifikimin e saktësisë dhe vërtetësisë së deklarimit të bëra në deklaratën “Vetting”.

**51.5.** Në DPV/2011 subjekti ka deklaruar kursime *cash* shumën 400,000 lekë. Pra, rezultoi se gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2011 (datë 31.12.2011) është në vlerën 400,000 lekë.

**51.6.** Në DPV/2012 subjekti ka deklaruar shtim në depozitën ekzistuese në “ProCredit Bank” shumën 400,000 lekë, me burim krijimi kursimet. Gjithashtu subjekti ka deklaruar kursime në *cash* vlerën 300,000 lekë. Nga ky deklaratim rezultoi se subjekti ka pakësuar gjendjen e likuiditeteve *cash* të deklaruar në fund të vitit 2011, e cila ka shërbyer si burim për shtesën e depozitës në “ProCredit Bank”, por gjithashtu ka deklaruar gjendje likuiditetesh shumën 300,000 lekë, e cila duket se është shtesë pasurie me burim të ardhurat e këtij viti. Pra, rezultoi se gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2012 (datë 31.12.2012) është në vlerën 300,000 lekë.

**51.7.** Në DPV/2013 subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit të markës “Daimler Chrysler”, në vlerën 3,000 euro, me burim krijimi kursimet *cash* të deklaruarra për vitin 2012 dhe kursimet nga pagat. Pra, rezultoi se kursimet në formë likuiditetesh *cash* të deklaruarra në vitin 2012 në shumën 300,000 lekë janë pakësuar plotësisht, pasi kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë së llojit “automjet”. Gjithashtu konstatohet se në këtë DPV subjekti ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash* shumën 200,000 lekë. Pra, rezultoi se gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2013 (datë 31.12.2013) është në vlerën 200,000 lekë.

**51.8.** Në DPV/2014 subjekti ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash* shumën 300,000 lekë. Në këtë DPV nuk rezultoi të ketë pasqyruar pakësim të gjendjes *cash* të deklaruar më parë, si rrjedhim rezultoi se gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2014 (datë

---

<sup>83</sup> Pyetësori nr. 2.



31.12.2014) është në vlerën 500,000 lekë (vlera 200,000 lekë deklaruar në DPV/2013 + vlerën 300,000 lekë deklaruar në DPV/2014).

**51.9.** Në DPV/2015 subjekti ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash* shumën 350,000 lekë. Në këtë DPV nuk rezulton të ketë pasqyruar pakësim të gjendjes *cash* të deklaruar më parë, si rrjedhim rezulton se gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2015 (datë 31.12.2015) është në vlerën 850,000 lekë (vlera 500,000 lekë si gjendje likuiditetesh *cash* e mbartur nga vitet 2013 dhe 2014 + vlerën 350,000 lekë deklaruar në DPV/2015).

**52.** Në DPV/2016 konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar shtesë apo pakësim të gjendjes së likuiditeteve *cash*, si rrjedhim, referuar vetëdeklarimeve të bëra nga subjekti rezulton se gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2016 (datë 31.12.2016) është në vlerën 850,000 lekë.

### **Vlerësimi i Komisionit**

**53.** Siç u pasqyrua më sipër, shtesat e likuiditeteve gjendje *cash* për vitet 2011 dhe 2012 kanë shërbyer si burim krijimi për shtesën e depozitës në “Procredit Bank” dhe blerjen e automjetit në vitin 2013.

**53.1.** Në këtë këndvështrim rezulton se si burim krijim i pasurisë në formë gjendjesh likuiditesh *cash* në vlerën 800,000 lekë kanë shërbyer shtesat e deklaruar në vitet 2013, 2014 dhe 2015, të cilat në total shkojnë në vlerën 850,000 lekë.

**53.2.** Në kushtet kur bazuar në deklaratat periodike vjetore të depozituara ndër vite në ILDKPKI rezulton se gjendja e likuiditeteve *cash* në fund të vitit 2016 paraqitet në vlerën 850,000 lekë, rezulton bindës deklarimi i bërë nga subjekti për gjendjen e likuiditeteve *cash* në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” (datë 24.1.2017), në shumën 800,000 lekë.

**53.3.** Gjithashtu, bazuar në analizën financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se vitet 2013, 2014 dhe 2015, vite, në të cilat janë deklaruar shtesat e likuiditeteve *cash*, që kanë shërbyer si burim krijimi i pasurisë objekt vlerësimi, paraqiten me balancë pozitive fondesh.

**53.4.** Në këtë kuptim, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht krijimin e gjendjes së likuiditeteve në shumën 800,000 lekë, deklaruar si gjendje në datën 24.1.2017.

**53.5.** Gjithashtu, në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar **pjesë takuese/të drejta reale mbi pasuri të llojit “tokë bujqësore”, të përfituar nga familjet bujqësore, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 dhe legjislacionit në vijim për fitimin e pronësisë mbi pasuritë e shpërndara me AMTP.** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar 25 % pjesë takuese të pasurisë së llojit “tokë bujqësore” prej 16,000 m<sup>2</sup>, në bazë të AMTP-së nr. \*\*\*\*\*, datë 6.6.1996, regjistruar në ZRPP-në Korçë në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore H. P. (babai), me nr. \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* pasurie.

**53.6.** Personi i lidhur ka deklaruar se ka si pjesë takuese sipërfaqen prej 2,340 m<sup>2</sup> tokë bujqësore, në bazë të AMTP-së nr. \*\*\*\*\*, e regjistruar në ZRPP-në Korçë në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore R. M. (babai i personit të lidhur) si pjesë ideale së bashku me pjesën tjetër të përfituar nga familja (në total 6200 m<sup>2</sup>) me nr. \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* pasurie. Pjesa takuese 2.340 m<sup>2</sup>.

**53.7. Deklarimi i këtyre pasurive në vite:** referuar deklaratës së interesave private para fillimit të detyrës<sup>84</sup> konstatohet se subjekti ka deklaruar 25% pjesë takuese për sipërfaqen totale prej 16,000 m<sup>2</sup> tokë bujqësore. Gjithashtu në këtë deklaratë janë deklaruar pasuritë e përfituara nga bashkëshorti i subjektit, si anëtar i familjes bujqësore me kryefamiljar z. R. M., si vijon: (i) pasuria nr. \*\*\*\*\* “arë” me sipërfaqe 2,147 m<sup>2</sup>, e ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*\*\*, volumi \*\*,

<sup>84</sup> Dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI në datën 30.3.2006.

faqe \*\*\*\*, pjesa takuese 25%; (ii) pasuria nr. \*\*\*\*, “pemëtore”, sipërfaqe totale 624 m<sup>2</sup>, e ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*\*, volumi \*\*, faqe \*\*\*\*, pjesa takuese 25%; (iii) pasuria nr. \*\*\*\* “arë” me sipërfaqe totale 1,080 m<sup>2</sup>, e ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*\*, volumi \*\*, faqe \*\*\*\*, pjesa takuese 25%; (iv) pasuri nr. \*\*\*\*, “arë” me sipërfaqe totale 2,200 m<sup>2</sup>, e ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*\*, volumi \*\*, faqe \*\*, pjesa takuese 25%; (v) pasuri nr. \*\*\*\*, “arë” me sipërfaqe 953 m<sup>2</sup>, e ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*\*, volumi \*\*, faqe \*\*\*\*, pjesa takuese 25%; dhe (vi) pasuria nr. \*\*\*\*, “arë” me sipërfaqe 900 m<sup>2</sup>, e ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*\*, volumi \*\*, faqe \*\*\*\*, pjesa takuese 25%.

**53.8.** Në DPV/2013 bashkëshorti i subjektit ka deklaruar shitjen e pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\*\* nga përfaqësuesi i familjes bujqësore R. M. (babai). Çmimi 260,208 lekë. Të ardhurat e përfituara nga ky transaksion 65,152 lekë (25% e shumës 260,208 lekë). Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Korçë<sup>85</sup> rezulton se me kontratën<sup>86</sup> e datës 17.6.2013 shtetasit R. dhe L. M. kanë shitur pasurinë e llojit “pemëtore” me nr. pasurie \*\*\*\*, sipërfaqe 624 m<sup>2</sup>, ndodhur në fshatin V\*\*\*\*, Korçë, për çmimin 260,028 lekë. Gjithashtu, po në datën 17.6.2013, shtetasit R. dhe L. M. kanë shitur<sup>87</sup> kanë shitur pasurinë e llojit “tokë arë” me nr. \*\*\*\* pasurie, sipërfaqe 1080 m<sup>2</sup>, ndodhur në fshatin V\*\*\*\*, Korçë, për çmimin 450,360 lekë.

**53.9.** E pyetur nga Komisioni në lidhje me mosdeklarimin nga ana e bashkëshortit në deklaratën periodike vjetore të të ardhurave të përfituara nga shitja e kësaj pasurie 2013, por as pakësimin e pasurisë së llojit “tokë arë”, me nr. \*\*\*\* pasurie, me sipërfaqe 1080 m<sup>2</sup>, të shitur me kontratën me nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 17.6.2013 nga prindërit e bashkëshortit, subjekti ka deklaruar se *për kontratën tjetër të lidhur në të njëjtën ditë nga ana e prindërve të bashkëshortit atë me nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 17.6.2013, për shitjen e pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 1080 m<sup>2</sup>, as personi i lidhur/bashkëshorti dhe as ajo nuk kanë pasur dijeni, deri në kohën që nga ata duhej të plotësoheshin formularët e deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, sipas ligjit nr. 84/2016, pasi duhej të deklaroheshin pasuritë ekzistuese, pjesë e të cilave janë edhe ato në bashkëpronësi që subjekti apo personi i lidhur ka me të tretët. Vetë personi i lidhur/bashkëshorti nuk është palë në atë kontratë, ndërkohë që dhe vetë palët kontraktore përkatësisht shitësit, nuk e kishin vënë në dijeni, ndërsa blerësi K. nuk kishte asnjë lloj detyrimi ta vinte në dijeni. Për këtë veprim juridik, për ekzistencën e të cilit janë njohur vetëm në vitin 2016 u është vënë në dispozicion nga prindërit e bashkëshortit kontrata e dytë e shitjes, ku janë njohur me objektin e kontratës si dhe me çmimin e përcaktuar në këtë kontratë nga palët kontraktuese. Në asnjë moment as në kohën e kryerjes prej tyre të veprimit juridik, as në vijim dhe as sot bashkëshorti nuk ka përfituar asnjë lloj shumë që buronte nga shitja e kësaj pasurie të paluajtshme. Rrjedhimisht nuk kanë pasur asnjë lloj dijenie për kryerjen e saj dhe për çmimin e përcaktuar nga palët në kontratë. Bashkëshorti nuk ka përfituar asnjë të ardhur nga kjo shitje.*

## Vlerësimi i Komisionit

**54.** Duke konsideruar faktin se bashkëshorti i subjektit nuk ka qenë palë në nënshkrimin e kontratave të shitblerjes së këtyre pasurive dhe për sa kohë personi i lidhur nuk ka pretenduar të ardhura nga shitja e pasurisë së llojit “tokë arë”, me nr. \*\*\*\* pasurie, sipërfaqe 1080 m<sup>2</sup>, të shitur në datën 17.6.2013, Komisioni vlerëson se janë bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me mosdeklarimin e bërë nga personi i lidhur në DPV-në e vitit 2013 dhe, si rrjedhojë, ky mosdeklarim nuk mund të ndikojë në vendimmarrjen përfundimtare. Për më tepër Komisioni

<sup>85</sup> Shkresa nr. \*\*\*\* prot., datë 24.9.2020.

<sup>86</sup> Kontrata nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 17.6.2013.

<sup>87</sup> Kontrata nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 17.6.2013.

vëren se në deklaratën “Vetting” personi i lidhur ka deklaruar saktësisht pasuritë në bashkëpronësi me familjarët e tij.

**54.1.** Si konkluzion, nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Korçë për këto pasuri, Komisioni konstaton se subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar saktë pjesën e tyre takuese mbi këto pasuri dhe se nuk ka dyshime për krijimin e tyre (pasuri të përfituara me ligj).

### **Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**55.** Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**55.1.** Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë, pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Pepi, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**55.2.** Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor.

**55.3.** Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaram dhe balanca negative e fondeve në vlerë relativisht të vogël, nuk janë të mjaftueshme që të sjellin zbatimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**55.4.** Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta, të konstatuara si më sipër, nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia.

**55.5.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Marsela Pepi, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**56.** DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**56.1.** Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin<sup>88</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, ku ka konstatuar se: i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaramuara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; dhe iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

<sup>88</sup> Raportin nr. \*\*\*\* prot., datë 31.10.2017.

**56.2.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016 DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela H. Pepi<sup>89</sup>.

**56.3.** Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Pepi, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**56.4.** Si konkluzion, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI PROFESIONAL**

**57.** Subjekti i rivlerësimit në periudhën 3 tetor 2005 – 5 nëntor 2006 ka kryer stazhin profesional si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës; në periudhën 6 nëntor 2006 – 5 korrik 2013 ka ushtruar detyrën si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; në datën 5 korrik 2013 është emëruar inspektore në Inspektoratin e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Me krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në dhjetor të vitit 2018 ka vijuar detyrën e inspektorit/nëpunës përgjegjës në njësinë e vlerësimit etiko- profesional pranë komisionit për vlerësimin e aftësive profesionale dhe etike të gjyqtarëve në KLGJ dhe në datën 7.2.2020 është komanduar pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në detyrën e inspektorit, detyrë të cilën e ushtron dhe aktualisht.

### **Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor<sup>90</sup>**

**57.1.** Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**57.2.** Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: 1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera, që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti; 2) pesë dokumenteve ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe 3) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

**57.3. Të dhëna nga burimet arkivore:** sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, për inspektoren Marsela Pepi, gjatë ushtrimit të kësaj detyre, nuk rezulton asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së. Gjithashtu, sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë për procedim apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.

**57.4.** Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: a) aftësive organizative; b) aftësive etike profesionale; c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit; dhe ç) angazhimi profesional.

### **Aftësitë organizative**

<sup>89</sup> Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\*\*, datë 29.10.2020.

<sup>90</sup> Raporti për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr. \*\*\*\* prot., datë 14.10.2020.

**a) Sasia:** përgjatë periudhës kalendarike 2013- 2016 subjekti i rivlerësimit Marsela Pepi në cilësinë e inspektorese së Inspektoratit të KLD-së, e caktuar në seksionin e inspektimit dhe verifikimit të ankesave, ka hartuar 741 raporte, nga të cilat 600 vetëm për periudhën 2014- 2016. Gjithashtu rezulton se inspektorja Pepi është ngarkuar dhe ka përfaqësuar KLD-në në disa çështje gjyqësore.

Përveç detyrës funksionale inspektorja është angazhuar në grupin e punës të KLD-së për hartimin e skemës së vlerësimit të punës së inspektorit, e miratuar me vendimin e KLD-së nr.36 datë 29.04.2015 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, si dhe në përgatitjen e akteve në zbatim të tij.

Sipas nenit 6, pika 2, shkronja “b” e sistemit të vlerësimit, inspektori i seksionit të inspektimit dhe verifikimit të ankesave duhet të hartojë raporte jo më pak se 150 ankesa në vit. Në vlerësimin e standardit sasior merret në konsideratë deri në masën 30% edhe volumi i detyrave të tjera të përmbushura nga inspektori.

Nga të dhënat statistikore të paraqitura nga KLGJ-ja për efekt të procedurës së shortimit të 5 dokumenteve rezulton se përgjatë periudhës së rivlerësimit 8.10.2013 - 8.10.2016, subjekti i rivlerësimit Marsela Pepi në cilësinë e inspektorese së Inspektoratit të KLD-së në seksionin e Inspektimit dhe të Verifikimit të Ankesave ka hartuar gjithsej 573 raporte, nga të cilat 201 raporte paraprake për të cilat është konkluduar arkivimi i ankesës, 19 raste janë pjesëmarrje në procese të tjera pune: përfaqësime në gjykatë, plane inspektimi tematikë si dhe ka kontribuar në përgatitjen e 6 inspektimeve tematike të ngarkuara nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. 553 raporte të tjera të hartuara nga ana e saj janë të natyrës reacione paraprake, për të cilat është propozuar verifikimi i ankesës, si dhe raporte verifikuese në grup inspektimi. Kjo sasi pune është kryer për një periudhë 2 vjet dhe 3 muaj dhe 9 ditë, pasi për periudhën 10.11.2015 - 1.8.2016 rezulton të ketë qenë me raport barrë lindjeje.

Sasia e akteve të hartuara nga subjekti i rivlerësimit dukshëm e kalon standardin sasior të përcaktuar në nenin 6 pika 2 shkronja “b” të vendimit nr. 36/2015 të KLD-së “Sistemi i vlerësimit të inspektorit dhe kryeinspektorit të KLD-së”, 450 raporte për 3 vjet, kur në fakt ka 573 raporte të hartuara për rreth 2 vjet e 3 muaj, tregues i volumit të lartë të ngarkesës të përballuar prej saj.

**b) Metodologjia:** nga vëzhgimi i 3 dokumenteve ligjore, të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe 5 dokumentet e përzgjedhura me short konstatohet se inspektorja ka aftësi shumë të mira metodologjike. Thelbi i detyrës kuptohet saktësisht prej saj. Menaxhon shumë mirë kohën dhe burimet e tjera në dispozicion në funksion të realizimit të afateve kohore, por pa anashkaluar saktësinë e veprimeve që duhen kryer. Në 5 dokumentet ligjore të vëzhguara, veprimet procedurale dokumentohen rregullisht dhe qartë.

Referuar raportit subjekti ka aftësi shumë të mira për të paraqitur saktë nga pikëpamja formale aktet dhe i përdor këto aftësi në funksion të organizimit të punës. Të 8 dokumentet e vëzhguara paraqiten të organizuar sipas standardeve të unifikuara në Inspektorat në drejtim të çështjeve që trajtohen.

**c) Shpejtësia:** nga 5 dokumentet e vëzhguara rezulton se të gjitha janë hartuar brenda afatit të parashikuar në nenin 6, pika 4, shkronja “a”, e vendimit nr. 36, datë 29.04.2015 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të KLD-së”. Kështu, 3 prej tyre janë realizuar brenda afatit normal 30-ditor, të parashikuar në nenin 6, pika 4, shkronja “a” e vendimit të KLD-së nr. 36/2015, ndërsa 2 raporte të tjera janë realizuar brenda afatit të caktuar shprehimisht në urdhrat e verifikimit, në përputhje me parashikimet e nenit 6, pika 4, shkronja “a” e vendimit të KLD-së nr. 36/2015.

### **Aftësitë profesionale teknike**

**a) Qartësia e hartimit të raportit:** subjekti i rivlerësimit ka aftësi të dukshme në hartimin e qartë të raporteve. Ajo i kushton vëmendjen e duhur strukturës formale, analizës ligjore, formulimit të qartë dhe të saktë të konkluzioneve. Në të 8 dokumentet e vëzhguar konstatohet se ajo identifikon saktë rrethanat e çështjes dhe ligjin e zbatueshëm, duke u treguar e kujdesshme në analizën e kontekstit të fakteve. Kujdeset të paraqesë në mënyrë kronologjike ecurinë e çështjes objekt verifikimi nga gjykimi në shkallë të parë deri në vendimin e gjykatës më të lartë në funksion të logjikës juridike të ndjekur në verifikim.

**b) Aftësia për të përdorur njohuritë juridike:** nga vëzhgimi i 8 dokumentave ligjore konstatohet se subjekti i rivlerësimit në ushtrimin e detyrës së inspektores së Inspektoratit të KLD-së, ka nivel shumë të mirë të njohurive mbi legjislacionin dhe jurisprudencën.

**c) Aftësia për të hartuar raportin sipas modeleve të caktuara:** nga vëzhgimi i 8 raporteve konstatohet se subjekti i rivlerësimit në të gjitha raset ka respektuar me përpikmëri modelet e unifikuara sipas llojit të punës. Ajo përshkruan me saktësi faktet, duke treguar burimin e provave të marra në verifikim, identifikon ligjin e zbatueshëm, bën një analizë shumë të mirë të tij dhe jep me qartësi konkluzionet për çështjen.

**d) Saktësia në hartimin e raportit:** nga vëzhgimi i 8 dokumenteve konstatohet se raportet e hartuara nga subjekti i rivlerësimit, si ato të shqyrtimit paraprak dhe ato të verifikimit të ankesës, janë të sakta nga ana profesionale. Ato nuk përmbajnë gabime ligjore apo materiale. Nga kontrolli hierarkik i bërë ndaj secilit raport, nuk janë konstatuar të meta, dhe në asnjë rast nuk ka patur kthime të raporteve për përmirësim të tyre. Në të 8 rastet propozimet e subjektit të rivlerësimit janë miratuar dhe janë ndjekur konkluzionet apo rekomandimet e dhëna nga ana e saj, tregues i cilësisë së hartimit të raporteve.

Në 3 dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit, propozimet e paraqitura nga ana e saj për fillim procedimi disiplinor janë përkrahur nga organet që ndërmarrin nisma proceduese dhe janë finalizuar me vendime për caktim masash disiplinore, bazuar pikërisht në gjetjet, konstatimet dhe analizën ligjore të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në raportet e veta.

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit**

**a) Etika dhe disiplina në punë:** përgjatë periudhës së rivlerësimit inspektorja Marsela Pepi shquhet për aftësinë e saj për të përmbushur në cilësinë e duhur detyrat e ngarkuara nga legjislacioni në fuqi si dhe nga organi epror i saj Kryeinspektori i KLD-së. Ajo ka treguar saktësi dhe shpejtësi në realizimin e detyrave. Dallohet për punën në grup, ku shfaqet e gatshme të marrë përsipër detyra, të japë udhëzimet e duhura sikundërse janë dhëna e rekomandimeve apo sugjerimet për t'u mbajtur në konsideratë gjatë verifikimit përkatës.

**b) Integriteti:** nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Marsela Pepi dhe nga 5 dokumentet e vëzhguara konstatohet aftësi të dukshme komunikuese, ndjenjën e përgjegjësisë në përmbushjen e detyrës, integritet dhe aftësi në ushtrimin e detyrës. Nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Po ashtu, ndaj saj nuk ka pasur asnjë rast për fillimin e procedurave disiplinore.

**c) Paanësia:** nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dokumentet e vëzhguara nuk janë gjetur raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Marsela Pepi. Nuk rezultojnë të jenë paraqitur ankesa ndaj saj për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të paanësisë përgjatë përmbushjes së detyrës, si nga qytetarët, ashtu dhe nga gjyqtarët. Në 8 dokumentet ligjore nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

## **Angazhimi profesional**

**a) Kriteret sociale:** në periudhën e rivlerësimit inspektorja është shfaqur e gatshme dhe e angazhuar për të punuar në grup. Ajo ka marrë pjesë në grupin e punës për hartimin e skemës së vlerësimit të inspektorëve, mbi bazën e të cilin vlerësohet në referim të ligjit nr. 84/2016. Nuk rezultojnë ankesa për punën e saj në grup përgjatë ushtrimit të detyrës së inspektores.

Gjithashtu shfaqet e gatshme për bashkëpunim në grup, duke marrë pjesë dhe dhënë kontribut në 6 inspektime tematike të zhvilluara në Inspektoratin e KLD-së, si dhe pjesëmarrëse në takimet e Këshillit Drejtues për të lehtësuar zbatimin e projektit “Mbështetje për efikasitetin e Drejtësisë SEJ”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës.

**b) Rritja profesionale:** subjekti i rivlerësimit është angazhuar si lehtësuese në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe se, gjithashtu, në periudhën 8.10.2013-8.10.2016 ka qenë pjesëmarrëse në 7 aktivitete trajnuese të kësaj shkolle.

Gjithashtu konstatohet angazhimi i subjektit të rivlerësimit me pjesëmarrje në disa trajnime të tjera të organizuara jashtë Shkollës së Magjistraturës, në të cilat temat e trajnimit kanë një lidhje të kënaqshme me detyrën e inspektores.

Subjekti i rivlerësimit ka ofruar bashkëpunim me pjesëmarrje në grupin e punës, të ngritur nga KLD për hartimin e skemës së vlerësimit të inspektorëve, që u finalizua me miratimin për herë të parë të një skeme vlerësimi për inspektorët me vendimin e KLD-së nr. 36, datë 29.4.2015 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit profesional dhe etik të kryeinspektorit dhe inspektorëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”.

## **Rivlerësimi i kryer nga Komisioni**

**58.** Hetimi i Komisionit për këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e raportit për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe në kriteret e vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

**58.1.** Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur 3 dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, 5 dokumentet e përzgjedhura me short, si edhe të dhënat nga burimet arkivore të ish-KLD-së.

**58.2.** Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, 5 dokumentet e përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

**58.3.** Gjithashtu nga verifikimi i regjistrit të ankesave të Komisionit rezulton që ndaj këtij subjekti nuk është depozituar asnjë ankesë/denoncim nga publiku.

## **Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

**59.** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara prej saj, konkludon se:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;

- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Marsela Pepi, gjyqtare, aktualisht e komanduar si inspektore pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik, vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 16.3.2021

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda Bekteshi**  
**Kryesuese**

**Lulzim Hamitaj**  
**Anëtar**

**Pamela Qirko**  
**Relatore**

Gledis HAJDINI  
Sekretare gjyqësore



## ANEKS 1 - ANALIZA FINANCIARE PËRMBLEDHËSE

|   | 2005           | 2006             | 2007             | 2008             | 2009             | 2010             | 2011             | 2012             | 2013             | 2014             | 2015             | 2016             |
|---|----------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| <b>A) PASURI</b>  | <b>259 281</b> | <b>130 382</b>   | <b>203 238</b>   | <b>442 841</b>   | <b>294 828</b>   | <b>207 867</b>   | <b>1 106 233</b> | <b>404 616</b>   | <b>880 852</b>   | <b>1 084 135</b> | <b>1 035 784</b> | <b>582 509</b>   |
| Automjeti marka "Daimler Chrysler" (D) tipi "C220 CDI", targa **** viti i prodhimit 12.12.2002, përfituar me kontratën e shitblerjes nr. **** rep., nr. **** kol., datë 5.9.2013. Vlera 3.000 euro. |                |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  | 420 630          |                  |                  |                  |
| Automjeti "Mercedes-Benz", tipi "250 D" targa **** (****) blerë me kontratën nr. **** rep., nr. **** kol., datë 3.11.2007 dhe e shitur me kontratën nr. **** rep., nr. **** kol., datë 25.5.2016.   |                |                  | 250 000          |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |
| Automjeti "Mercedes - Benz" tipi "190" **** blerë në datë 26.10.2005  | 250 000        |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |
| Ndryshim likuiditeti  | 9 281          | 130 382          | -46 762          | 442 841          | 294 828          | 207 867          | 1 106 233        | 404 616          | 460 222          | 1 084 135        | 1 035 784        | 582 509          |
| <b>TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR</b>  | <b>9 281</b>   | <b>139 663</b>   | <b>92 901</b>    | <b>535 742</b>   | <b>830 570</b>   | <b>1 038 437</b> | <b>2 144 670</b> | <b>2 549 286</b> | <b>3 009 508</b> | <b>4 093 643</b> | <b>5 129 426</b> | <b>5 711 935</b> |
| <b>B) DETYRIME</b>  | <b>0</b>       | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>         |
| <b>PASURI NETO</b>  | <b>259 281</b> | <b>130 382</b>   | <b>203 238</b>   | <b>442 841</b>   | <b>294 828</b>   | <b>207 867</b>   | <b>1 106 233</b> | <b>404 616</b>   | <b>880 852</b>   | <b>1 084 135</b> | <b>1 035 784</b> | <b>582 509</b>   |
| <b>C) TË ARDHURA</b>  | <b>790 877</b> | <b>1 196 995</b> | <b>1 461 546</b> | <b>1 301 643</b> | <b>1 466 020</b> | <b>1 458 275</b> | <b>1 590 869</b> | <b>1 546 738</b> | <b>1 866 702</b> | <b>1 930 588</b> | <b>2 296 277</b> | <b>1 651 356</b> |
| Të ardhura SR nga Shkolla e Magjistraturës (bursa dhe si lehtësuese)  | 348 975        | 0                | 0                | 0                | 0                | 0                | 0                | 0                | 0                | 0                | 7 372            | 0                |
| Të ardhura SR (paga)  | 106 720        | 819 617          | 831 367          | 881 072          | 899 821          | 460 716          | 809 295          | 918 223          | 1 041 634        | 1 171 358        | 1 155 481        | 396 641          |
| Të ardhura ISSH (leje lindje SR)  |                |                  |                  |                  | 55 944           | 179 487          |                  |                  |                  |                  | 128 709          | 302 965          |
| Të ardhura nga shitja e tokës bujqësore të bashkëshortit  |                |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  | 65 052           |                  |                  |                  |
| Të ardhura nga paga e bashkëshortit   | 335 182        | 377 378          | 430 179          | 420 571          | 488 365          | 555 836          | 655 562          | 536 117          | 619 451          | 594 933          | 619 594          | 650 990          |
| Të ardhura nga interesat nga depozita bankare (ProCredit Bank)  |                |                  |                  |                  | 21 890           | 22 236           | 36 012           | 22 398           | 70 565           | 30 530           | 37 550           | 43 320           |
| Të ardhura nga interesat nga depozita bankare (BKT)   |                |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  | 33 767           | 7 571            | 7 440            |
| Të ardhura nga shitja e mjetit "Mercedes-Benz" tipi "190" targa **** blerë 26.10.2005 dhe shitur 15.11.2007   |                |                  | 200 000          |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |
| Të ardhura nga shitja "Mercedes - Benz" tipi "250 D" targa **** (****) shitur me kontratën nr. **** rep., nr. **** kol., datë 25.5.2016.  |                |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  | 200 000          |
| Të ardhura nga dhurimet për fëmijët (familjarët dhe të afërmit)   |                |                  |                  |                  |                  | 240 000          | 90 000           | 70 000           | 70 000           | 100 000          | 340 000          | 50 000           |
| <b>E) SHPENZIME</b>   | <b>483 613</b> | <b>605 299</b>   | <b>803 240</b>   | <b>913 543</b>   | <b>654 625</b>   | <b>708 801</b>   | <b>626 730</b>   | <b>670 426</b>   | <b>610 595</b>   | <b>747 572</b>   | <b>952 227</b>   | <b>1 037 762</b> |
| Shpenzime jetese  | 219 114        | 219 114          | 273 240          | 273 240          | 284 625          | 409 860          | 409 860          | 423 072          | 423 072          | 659 994          | 642 105          | 940 368          |
| Shpenzime për pagesë qiraje në Gjirokastrë  |                | 30 000           | 180 000          | 180 000          | 180 000          | 180 000          | 180 000          | 184 000          | 102 000          |                  |                  |                  |
| Shpenzime për pagesa studimesh bashkëshorti në univesritetin L.G.   |                | 150 000          | 150 000          | 150 000          | 150 000          |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |
| Shpenzime për arsimin e personit të lidhur K.M (djali)  |                |                  |                  |                  |                  |                  |                  | 8 800            | 33 200           | 60 000           | 112 084          | 97 394           |
| Shpenzime për arsye shëndetësore (Klinika Obstetrike "Plus")  |                |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  |                  | 138 038          |                  |
| Shpenzime për pagesë licence avokatie   |                |                  |                  |                  |                  | 112 000          |                  |                  |                  |                  |                  |                  |
| Shpenzime udhëtimi TIMS   | 149 499        | 6 185            | 0                | 180 303          | 0                | 6 941            | 36 870           | 54 554           | 52 323           | 27 578           | 0                | 0                |
| Shpenzime për mobilim apartamenti 3+1 në Tiranë   | 115 000        | 200 000          | 200 000          | 130 000          | 40 000           |                  |                  |                  |                  |                  | 60 000           |                  |
| <b>F) ANALIZA FINALE (D-C-E)</b>  | <b>47 983</b>  | <b>461 314</b>   | <b>455 068</b>   | <b>-54 741</b>   | <b>516 567</b>   | <b>541 608</b>   | <b>-142 094</b>  | <b>471 696</b>   | <b>375 255</b>   | <b>98 881</b>    | <b>308 266</b>   | <b>31 085</b>    |